



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura IV
Sesioni vjeshtor

Komisioni për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri

Mbledhja nr.30/2011
Prishtinë, më 13.09.2011, ora 11:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla C-203

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR ZHVILLIM EKONOMIK, INFRASTRUKTURË,
TREGTI DHE INDUSTRI

Në mbledhje morën pjesë: Zenun Pajaziti - kryetar, Teuta Sahatqija, Fikrim Damka, Sala Berisha-Shala, Hashim Deshishku, Lutfi Zharku, Visar Ymeri, Ramiz Kelmendi dhe Myzejene Selmani.

Munguan: Berat Buzhala dhe Biserka Kostić.

Pjesëmarrësit e ftuar: Besim Beqaj - Ministër i Zhvillimit Ekonomik (MZHE), Ali Hamiti - Zyra e Rregullatorit të Energjisë (ZRRE), Arben Gjokaj - Korporata Energjetike e Kosovës (KEK), Berat Rukiqi - Oda Ekonomike e Kosovës (OEK), dhe Agim Shahini, Aleanca Kosovare e Biznesit (AKB).

Pjesëmarrës të tjerë: Frymëzim Jusufaj dhe Lirdon Mavriqi – MZHE, Naim Sahiti dhe Avni Alidemaj – KEK, Hamdi Jaha - AKB, Haxhi Gashi USAID/Deloitte, Radica Nursdorfec- ECLO, Agron Demi - GAP, Shefki Kastrati - NDI dhe Lejla Selimi – OSBE.

Stafi mbështetës i Komisionit: Armend Ademaj, Besim Haliti dhe Brikena Hoxha - konsulente e Komisionit.

Mbledhjen e kryesoi Zenun Pajaziti, kryetar i Komisionit.

Për këtë mbledhje u propozua ky rend dite:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e datës 06.09.2011;
3. Seancë dëgjimore për çështjet që lidhen me sektorin e energjisë elektrike;
4. Të ndryshme.

Kryesuesi konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe e hapi mbledhjen me pikën e parë të rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa vërejtje.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së datës 06 .09.2011

Procesverbali nga mbledhja e datës 06.09.2011 u miratua pa vërejtje.

4. Seance dëgjimore për çështjet që lidhen me sektorin e energjisë elektrike

Kryetari –Tha se për këtë pikë të rendit të ditës, ka qenë qëndrim i përbashkët i të gjithë anëtareve të Komisionit në mbledhjen e fundit për të mbajtur një seancë dëgjimore me të gjitha palët që kanë të bëjnë me sektorin e energjisë elektrike, kështu që i kemi ftuar këta përfaqësues: Besim Beqaj - Ministër i Zhvillimit Ekonomik, Ali Hamiti - kryetar i Bordit të Zyrës së Rregullatorit të Energjisë, Arben Gjukaj- Korporata Energjetike e Kosovës, Safet Gerxhaliu - Oda Ekonomike e Kosovës (zëvendësuar nga z.Berat Rukiqi), dhe Agim Shahini - Aleanca Kosovare e Biznesit. Pastaj ua dha fjalën të ftuarve për të raportuar dhe paraqitur konstatimet e tyre në lidhje me sektorin e energjisë.

Të gjithë të ftuarit si: z.**Besim Beqaj** - Ministër i Zhvillimit Ekonomik, z.**Ali Hamiti** - kryetar i Bordit të Zyrës së Rregullatorit të Energjisë, z.**Arben Gjukaj** - drejtor menaxhues i Korporatës Energjetike të Kosovës, z.**Berat Rukiqi** - Oda Ekonomike e Kosovës, dhe **Agim Shahini** - Aleanca Kosovare e Biznesit, dhanë opinionet e tyre para Komisionit në lidhje me sektorin e energjisë.

Anëtarët e Komisionit **Teuta Sahatqija, Myzejene Selmani, Visar Ymeri, Sala Berisha – Shala, Ramiz Kelmendi dhe Hashim Deshishku**, shprehën qëndrimet e tyre dhe shtruan pyetje për të ftuarit në lidhje me këtë çështje.

Pas debatit Komisioni njëzëri nxori këtë

Konkluzion

Në mbledhjen e radhës, të nxjerrin Rekomandimet e nevojshme nga kjo seancë dëgjimore.

5. Të ndryshme

Çështje vijuese.

Pjesë e këtij procesverbali është transkripti i kësaj seance dëgjimore.

Mbledhja përfundoi në orën 13:30.

Përgatiti:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit

Kryetari i Komisionit

Zenun Pajaziti



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

TRANSKRIPT
I DEBATIT PUBLIK TË KOMISIONIT PËR ZHVILLIM
EKONOMIK, INFRASTRUKTURË, TREGTI DHE INDUSTRI TË MBAJUR MË
13.09.2011

SA JAVNE RASPRAVE KOMISIJE ZA EKONOMSKI RAZVOJ,
INFRASTRUKTUTU, TRGOVINU I INDUSTRIJU ODRŽANOG DANA
13.09.2011

SHTATOR – SEPTEMBAR
2011

E martë, më 13.9.2011

Drejtton seancën: Kryetari i Komisionit, zoti Zenun Pajaziti

KRYETARI: Kolegë deputetë,

A mundemi të fillojmë? Kërkoj falje, paraprakisht për pak vonesë, prita deri sa të vijnë edhe shumica e deputetëve. Si duket kishin mundur ndërkohë ata me ardhur.

Faleminderit, shumë! Për takimin e radhës të Komisionit për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri, kemi paraparë të kemi një seancë dëgjimore për çështje që lidhen me sektorin e energjisë elektrike. Ky ka qenë një vendim i takimit nga mbledhja e fundit e komisionit, kemi paraparë që kjo të jetë sot dhe të jenë të ftuar:

- Ministri i Shërbimit Ekonomik, zoti Beqaj, nga Zyra e Rregullatorit të Energjisë,
- Zoti Hamiti, pastaj nga Korporata e Energjisë Elektrike Arben Gjokaj,
- Nga Oda Ekonomike, Safet Gërxhaliu
- Nga Aleanca Kosovare e Biznesit, zoti Agim Shahini

Unë ju dëshiroj mirë se ardhje, të gjithëve dhe nëse pajtoheni menjëherë ta fillojmë këtë takim, sa për ta zbatuar anën formale, meqenëse ne këtë e kemi mbledhje të rregullt dhe sa për të plotësuar miratimin e këtij rendi të ditës. Kemi vetëm këtë pikë, a pajtoheni për rendin e ditës, kush është “për”? “kundër” s’ka, faleminderit!

Atëherë, miratimi i procesverbalit, nga mbledhja e datës 6 domethënë, kolegë deputetë i keni kopjet e procesverbalit, nëse dikush nga ju ka diçka që mund të... nëse jo e ... procesverbalin për këtë, “kundër” s’ka, faleminderit! Dhe kalojmë në pikën 3. Edhe njëherë, ju shprehi mirë se ardhjen, zoti ministër, Përfaqësues të institucioneve tjera, zoti Hamiti, zoti Gjoka, zoti Shahini, ndërkohë besojmë nga vjen edhe përfaqësuesi i Odës Ekonomike të Kosovës.

E di që keni angazhimet e tua të shtuara këto ditë, megjithatë është në interes të, jo vetëm të komisionit tonë, por edhe të Kuvendit në përgjithësi. Kemi informacione shtesë, për çështjet që lidhen me energjinë elektrike në prag të sezonit që po vjen. Ne e dimë që zakonisht shtohen telashet me sezonin e dimrit me energjinë, edhe pse, vitet e fundit kemi pasur një përparim cilësor në sferën e energjisë elektrike dhe po ashtu, kemi përparuar edhe në legjislacion, ju e dini, në ndërkohë kemi bërë disa ligje që kanë qenë të sponsorizuara nga ju dhe po ashtu, kemi hasur në prezantimin e disa planeve, projekteve tuaja që kanë të bëjnë edhe në fushën e organizimit dhe menaxhimit të këtij sektori.

Pa dashtë, të fokusohemi në çështjet që janë shumë konkrete, ne mendojmë që ato do t’i shtroni ju. Ne sot jemi që të ju dëgjojmë ju dhe pastaj, kolegët deputetë të jenë të kyçur në këtë seancë dëgjimore.

Fillimisht, kishim me filluar me ministrin e Energjisë, ministrin e Shërbimit Ekonomik, zoti ministër ka disa çështje që ju i keni në kompetencë, përveç tjerash ju i përgatitni politikat e eficiencës së energjisë dhe po ashtu, burimeve të ripërtitshme të energjisë, si dhe planet, veprimet në këto dy fusha që janë në përputhje me direktivat e BE-së. Janë kryesisht, këto çështje që ne shprehim interesim më të madh, në ndërkohë edhe deputetë, kolegë tjerë, besojmë te interesimet e tyre. Por, edhe për çështjet tjera që unë i përmenda më herët që jemi në prag të zezonës, çështje që kanë të bëjnë me vendimet e fundit edhe të KEK-ut dhe çështjet tjera, ju lutem të bëni një prezantim të tyre edhe çështjeve tjera që ju i vlerësoni me interes. Faleminderit, shumë!

BESIM BEQAJ: Faleminderit, zoti kryetar!

Të nderuar deputetë,

Përfaqësues të mediave,

Profesor, Arben, Agim me kënaqësi ju kemi përgjigjur ftesës suaj, për të diskutuar për këtë çështje jashtëzakonisht të rëndësishme, siç është investimi në energji elektrike, por edhe procesi i ri formave strukturale, të cilat janë duke ndodhur në këtë sektor.

Dëshiroj të theksoj që në fillim që Ministria e Zhvillimit Ekonomik, në përbërjen e saj ka edhe sektorin e energjisë dhe është përgjegjëse për punët e politikave, bazës ligjore, të cilat duhet të korrespondojnë për strukturimin e përgjithshëm ekonomik të vendit, pjesën tjetër operative qoftë në gjenerim, qoftë në rregullim të këtij sektori, për rregullim e ka, procedura e rregullatorit të energjisë, program i cili i përgjigjet Kuvendit të Republikës së Kosovës, ndërsa çështjen, në këtë rast, të gjenerimit, por edhe furnizimin për momentin e ka KEK-u, si ndërmarrje publike, të cilën ne e monitorojmë konform kompetencave të atij ligji në debate publike, përmes njësisë për monitorimin e ndërmarrjeve publike, e cila ka për synim bazik që të shihet, se a ka udhëheqje korporatave dhe a ka funksionim të mirëfilltë të interesave të aksionarit, që në këtë rast, përmes Ministrisë së Zhvillimit Ekonomikë, ministria është përfaqësues i aksionarit në ndërmarrjen, pra në Korporatën Energjetike të Kosovës.

Dëshiroj të theksoj, se ne konformë kompetencave tona ju kemi qas këtij problemi, qoftë në Ligjin për licencën e energjisë, të cilin e kemi aprovuar në Kuvend dhe tani janë duke u marrë masat tjera për adaptim të legjislacionit apo akteve tjera nën legjislative, të cilat e pasurojnë qoftë me rregullore të ndryshme. Në ndërkohë, i kemi hyrë procesit të platformës strukturale dhe ajo formë ri strukturale nënkupton që KEK-u, ka ekzistuar njëherë si ndërmarrje e përgjithshme, e cila në ndërkohë është ndarë në 3 njësi, është kosti që merret me ose operatorit të sistemit të transmisionit, është KEK-u si gjenerues dhe ndërmarrja për furnizim dhe për shpërndarje të energjisë elektrike. Pra, i kemi 3 njësi, të cilat realisht i kanë kompetencat shumë më të specifikuara, të cilat janë duke bashkëpunuar në mënyrë shumë efikase me njëra-tjetrën.

Në këtë kontekst ne kemi filluar procesin e privatizimit për shpërndarje dhe furnizim, i cili ka për synim eliminimin e, së pari të gjitha angazhimet financiare, buxhetore që Qeveria e Kosovës në bazë për substencionime të caktuara, por njëkohësisht edhe një furnizim më të mirë, duke tentuar për t'i eliminuar humbjet teknike dhe humbjet komerciale, të cilat na rrjedhin gjatë procesit të konsumit të energjisë elektrike.

Ky proces siç kemi pas rastin edhe më herët të diskutojmë, dhe ne e kemi lëshuar dhe edhe një komunikatë për shtyp, e cila ka bë shpjegim se në çfarë nivele është procesi i privatizimit. Ne kemi ndërmarrje, të cilat janë të para kualifikuara, kemi hapur dhomën e informimit, ka komunikim të rregullt, kemi komunikuar me sindikatat dhe presim që brenda afateve, të cilat janë të parapara në planin e Qeverisë, kjo të përmbyllet. Dua të theksoj, se kjo gjithmonë referohet obligimeve, të cilat ne i kemi të bëjmë si Qeveri, në raport me investitorët, por edhe në raport me procesin dhe ne i kemi kryer të gjitha obligimet tona, normalisht tani procesi është në duart e investitorëve dhe ne duhet të sillemi konformë edhe kërkesave të investitorëve dhe konformë planeve, të cilat ata i kanë.

Po që se, s'je duke i respektuar normal dhe limitet kohore, të cilat ne ju kemi dhënë planin tonë të veprimit për proces të privatizimit. Pjesë e transformimit dhe ristrukturimit të përgjithshëm është edhe ndërtimi i termocentralit Kosova e Re. Proces, i cili është filluar shumë më herët, gjatë këtyre ditëve ka pasur shumë debate nëpër media, të cilat apo qoftë edhe shoqëria civile.

Dëshiroj të theksoj, para jush kështu që prej korrikut ne kemi pasur lidhje të vazhdueshme të shoqërisë civile, për ta diskutuar këtë çështje dhe nuk kemi marrë përgjigje, nuk kemi përgjigje, sepse na kanë thënë që ende nuk janë dokumentet e plotësuara dhe ne dëshirojmë të...

Kemi pasur kërkesa nga ta, për qasjen e dokumenteve zyrtare dhe neve na është dashur t'ju përgjigjemi, se qasjen në dokumente zyrtare mund të kenë, vetëm atëherë kur dokumentet janë publike, por jo kur janë draft, sepse ato mund ta dëmtojnë procesin e tillë. Në ndërkohë, kemi parë edhe një konferencë para disa ditësh, ku thuhet që : Banka Botërore ka standarde të dyfishta, trefishta... ku ta di unë çka, dhe që ne kemi bë një reagim, se për çdo gjë ku nuk kemi qenë të ftuar ne në debat, për çdo gjë është mirë që të komunikojmë me dokumente, do të thotë, jo vetëm kur ka zhvillime mediatike, të cilat nganjëherë edhe po e dëmtojnë procesin.

E vërteta është, se Banka Botërore e përkrah procesin e ndërtimit të Kosovës së Re, e vërteta është që kemi pas një vonesë, për shkak të përzgjedhjes së këshilltarit të transaksionit që ka pas një proces, i cili është duke ndodhur për prokurimin në Bankën Botërore dhe ne pa e përmbyllë atë nuk kemi mundur të bëjmë lëvizje të drejtpërdrejta, por ne si ministri kemi marrë vendim që procesin e përzgjedhjes së këshilltarit të transaksionit ta bëjmë vetë, me mjetet tona të buxhetit dhe kjo procedurë është hapur dhe realisht është përkrahur edhe nga banka botërore.

Pra, kemi partneritet të plotë me Bankën Botërore, është konsideruar si interes. Ka shumë debate të asaj që është energji e “ndytë” apo një energji e “pastër”, dëshiroj të theksoj para jush, si të zgjedhur të popullit, se ne kur të marrim masa dhe vendime për furnizim të energjisë elektrike duhet të jemi të kujdesshëm dhe ai kujdes duhet të bëhet për harmonizim në mes të interesave të konsumatorit dhe procesit të sektorit të energjisë në tërësi.

Pse po them të konsumatorit? Sepse ne duhet të balancojmë, me mundësinë e konsumatorit për të paguar energjinë elektrike dhe me sigurimin, në mundësi për t’ju siguruar atyre energji elektrike, e cila është e vazhdueshme. Në këtë kontekst dëshiroj t’ju informoj, se kostoja për prodhim të energjisë elektrike konform gjendjes që e kemi është 22 deri 28 euro, për megabajt, përderisa energjia e ri përtrishme është dikur 5 herë më i shtrenjtë.

Dhe ne jemi mjaftë të kujdesshëm duke pas dëshirën tonë maksimale që të kemi energji të pastër plotësisht, por gjithsesi duhet të jemi të kujdesshëm kur të marrim hapa të tillë që konsumatorët tonë të kenë mundësi për ta paguar atë rrymë dhe të kenë mundësi për ta konsumuar atë rrymë, në mënyrë efikase.

Prandaj, kjo është jo pse dikush është opozitë e energjisë së pastër dhe dua të them që një qasje, e cila kohët e fundit është aktuale pas Fokushimës, pra katastrofës në Japoni, kemi një riorientim të politikave energjetike në nivel botëror, ndaj ai riorientim është që shumë shtete janë duke menduar shumë seriozisht, për ta kthyer në fuqi prodhimin e energjisë nga leniti. Shembull, në këtë drejtim është edhe Gjermania, e cila pas shumë vitesh të ndërprerjes të energjisë elektrike me prodhim nga leniti, ka marrë vendim për rikthim të tyre, sepse teknologjia që ne e kemi marrë për obligim në raport me Bankën Botërore, por për ndërtimin e Kosovës së Re, ajo është teknologjia më e mirë e mundshme, e cila realisht eliminon mundësitë e dëmtimit të ambientit.

Prandaj, në këtë këndvështrim dëshiroj që të jem jashtëzakonisht i hapur dhe që të bëjë thirrje për të gjithë ata, të cilët dëshirojnë të diskutojnë për çështjen e energjisë, ju kisha lutur që të janë, t’u drejtohen më shumë edhe shoqërisë civile, por edhe tjerëve duke pas parasysh, se ju si deputetë keni komunikim edhe me ta që janë procese të rëndësishme, të cilat duhet të trajtohen konform interesit të qytetarit të Republikës së Kosovës. Dhe, kjo është arsye pse ne marrim këso hapash.

Lidhur me situatën e re të krijuar tash, për furnizim me energji elektrike, dëshiroj t’ju theksoj që ne kemi hyrë në remont substancial të Kosovës B, me paralajmërim për konsumatorët dhe qytetarët që do të ketë reduktime, për shkak se remonti do të jetë i detajizuar dhe do të zgjasë së paku 2 muaj, në ndërkohë ka pasur edhe probleme teknike dhe në qëllim që biznesi dhe ekonomia të furnizohen sa më mirë me energji elektrike, do të thotë, është marrë një vendim për t’i trajtuar me

korrektësi të gjitha subjektet ekonomike dhe jo vetëm subjektet ekonomike, sepse kur të flasim për “A+”-in, “A+” ka të bëjë edhe me spitalet, ka të bëjë edhe me institucionet të cilat janë vitale për shtetin, prandaj “A+” nuk i dedikohet vetëm bizneseve, por edhe institucioneve vitale të shtetit.

Ky vendim, daton në vitin 2005, ku Qeveria e Kosovës ka marrë një vendim për furnizim në prioritet me energji elektrike, ka rastisë që atëherë kam qenë kryetar i Odës Ekonomike dhe bashkë me biznesin kemi bërë një lobim të fuqishëm që biznesi të hyjë në marrëdhënie kontraktuale me KEK-un, i cili ... marrë obligimet e veta në rast të ... energjisë elektrike. Kjo është në funksion që nga viti 2005 deri sot, në qershor të këtij viti ka ndodh një dizajnim i kriterëve, i cili ka pa gjatë inspektimit në dalje, të cilat janë mbi 300 biznese që kanë qenë të kyçura në dalje “dhjetëshe” që quhet në terminologjinë energjetike.

Ka pasur humbje të caktuara, ka pas mos respektim të kriterëve, por ka pas edhe shumë ndërmarrje, të cilat i kanë respektuar dhe i respektojnë edhe sot kriteret. Kriteret atëherë kanë qenë 3 fatura të parapaguara, zakonisht reflektimi nga biznesi ka qenë, se është parapaguar një faturë, por KEK-u nuk ka bërë probleme, në afate të gjata kohore, në ndërkohë ka qenë edhe obligimi që të jenë, të kenë mundësi për kyçe teknike dhe obligimet tjera.

Ajo çka e dallon tash vendimin e 2005-ës, me këtë është, se kërkohet 25% parapagim që nga biznesi është konsideruar e pa përballueshme, edhe pse kanë qenë në marrëdhënie kontraktuale më herët. Kërkohet të kenë qasje direktivitetin, direktiviti nënkupton që bizneset hyjnë në marrëdhënie kontraktuale me bankën që faturimi të shkon drejtë në bankë dhe banka ta bëjë pagesën konform vendimit, të cilit i jep ndërmarrja paraprakisht në momentin kur hyjnë në marrëdhënie kontraktuale dhe e fundit, komercialet që janë, të mos jenë më shumë se 1 %, do të thotë, në biznesin për me dalë në “10-she”.

Kjo nënkupton që realisht, humbjet komerciale të mos ketë manipulime me energji, pse është 1 %? Sepse është debatuar, pse s’është 0%? Sepse është evidentuar nga ana e KEK-ut që mund të ketë humbje teknike, të cilat KEK-u nuk dëshiron t’i adresojë në mënyrë të drejtpërdrejtë në këtë rast subjektit afarist.

KEK-u i ka njoftuar të gjitha këto ndërmarrje gjatë vlerësimit, i cili është bërë për një periudhë të caktuar. Është vlerësuar që një numër i madh janë ri kualifikuar konform kriterëve të cilat janë vendos, ndërsa një numër tjetër kemi has në humbje të theksuar komerciale në rrjetin, i cili ka qenë 10-she dhe realisht tash është provuar që do të hyjë në marrëdhënie kontraktuale.

Ne kemi marrë ankesa nga Asociacionet e bizneseve, ne kemi bërë takime me ta. Kemi kërkuar që si ministri që ne do të monitorojmë zbatimin e marrëveshjeve mbarë kombëtare, por ne nuk jemi institucion, i cili vë në marrëdhënie kontraktuale në mes të KEK-ut dhe subjekteve në këtë rast..., sepse ato

marrëdhënie kontraktuale bëhen në bazë të interesave bilaterale afariste të dy subjekteve, por në rast se ka çfarëdo lloj mos respektimi të këtyre marrëdhënieve kontraktuale nga ana e KEK-ut posaçërisht, atëherë ne jemi të thirrur që të veprojmë si monitorues në ndërmarrje publike.

Në ndërkohë, AKP-ja u ka orientuar Zyrës së Rregullatorit me një kërkesë, ta rishqyrton dhe Zyra e Rregullatorit ka kërkuar shpjegim nga KEK-u, KEK-u u ka treguar të gjitha masat, të cilat i ka marrë dhe Rregullatori është deshtë me një vendim ka eliminuar furnizimin me energji, do të thotë, furnizimin me prioritet në tërësi, sepse ofron rregullat, të cilat Rregullatori i ka. Është dashtë në procedurë të përdoren nga KEK-u për t'i akredituar këtë masë të re, këtë kategori të re dhe realisht ne si ministri konform këtij vendimi, duke marrë parasysh edhe kërkesat e biznesit po edhe interesin tonë si Qeveri që jemi të interesuar për t'i ofruar furnizim me energji elektrike subjekteve, të cilat kryejnë punësim dhe drejtpërdrejtë zhvillim ekonomik, kemi prioritet, ne kemi kërkuar edhe nga KEK-u që menjëherë t'i merr masat që ta njofton Rregullatorin me masa të reja dhe të kërkon d.m.th. aplikimin e masave të reja, të cilat janë.

Por, njëkohësisht kemi kërkuar që ata të cilët janë kualifikuar të mos ju ndërpritet furnizimi me prioritet, për shkak se është interes i zhvillimit ekonomik. Kjo është një përshkrim i gjendjes dhe normalisht, Zyra e Rregullatorit... kemi biseda të rregullta, sepse tani edhe në fazën e aprovimit të metodologjisë së tarifave, fazë e cila ka shkuar përmes Kuvendit dhe debatit publik, përkundër insistimit nga ana e Rregullatorit që muajin e kaluar konform bazës që e kanë pasur për me i aprovuar tarifat e metodologjisë, unë kam kërkuar personalisht që ta shtyjme edhe për 2 javë, zbatimin e tyre duke kërkuar që secili akter, i cili ka... interesi që merret me tarifat, të ketë mundësinë ta diskuton me Rregullatorin për rekomandimet, të cilat e kanë dhënë, a janë apo nuk janë të arsyeshme dhe normalisht rregullatori pritët që brenda një afati shumë të shkurtër t'i aprovon tarifat dhe që realisht, tarifat duhet të bëhen me dije që nuk janë kompetencë e KEK-ut, janë kompetencë e Rregullatorit, sepse në opinion shumë shpesh përzihen këto kompetenca, KEK-u ka kërkuar edhe më herët ngritje të tarifave rregullatori e mban përsipër stabilizimin e sistemit dhe harmonizimin e interesave të tri palëve që janë së paku, është: konsumatori, KEK-u furnizimi dhe është distribucioni, që në kuadër të kësaj të ketë një harmonizim të mirëfilltë.

(Ndërrhyrje: e treta është legjislacioni...)

BESIM BEQAJ: Por, në detale sigurisht që edhe profesori ... me dhënë shpjegime të veta. Gjithsesi, unë kërkoj dhe kam kërkuar nga të dy institucionet e rëndësishme që te ekonomia duhet të kemi kujdes të veçantë për furnizim me energji elektrike, për shkak se ne kemi deklaruar që është prioritet zhvillimi ekonomik dhe ky prioritet është obligim edhe i institucioneve, të cilat merren me furnizim, por edhe me rregullim, por edhe me shpërndarjen e energjisë elektrike.

Dhe, çdo shmangie nga baza legislative, secili prej nesh jemi përgjegjës para disa institucioneve dhe përgjegjësia jonë do të jetë që ne të sjellim në konform marrëdhënien kontraktuale dhe konform ligjeve, të cilat janë ekzistuese. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, zoti ministër!

Kishim kaluar te Zyra e Rregullatorit të Energjisë, te zoti Hamiti. Zoti Hamiti, Zyra juaj është një organ, i cili ka për detyrë t'i rregullojë aktivitetet e energjisë në Kosovë, po ashtu gjitha këto aktivitete të juaja, besoj që janë në frymën e një traktati që ka qenë i nënshkruar 2005, ka BE që ka të bëjë po ashtu, me tregun e integruar të energjisë dhe çështjet tjera që kanë të bëjnë me licencat dhe respektimin e tyre, ju po ashtu, jeni organ që e lëshoni dhe e monitoroni zbatimin e tyre po ashtu, edhe të tarifave dhe çështjet tjera që ju i shini me interes ...

Le të merr fjalën zoti Hamiti!

ALI HAMITI: Faleminderit, zoti kryetar!

Të nderuar deputetë,

Përfaqësues tjerë të institucioneve që kanë interes për këtë debat sot, për këtë seancë dëgjimore lidhur me energjinë dhe sektorin e energjisë në Kosovë.

Po më vjen mirë që në këtë përbërje jemi këtu bashkë, për të shqyrtuar një lëmi që është shumë me interes për çdo shtet edhe për Kosovën, gjithsesi, është energjia. Energjia është jetë... ministri shumë detajisht e tha një historik të zhvillimeve në sektorin e energjisë që i kanë paraprirë, në një formë e kanë nxit edhe këtë mbledhje që të mbahet. Pra, është... për të mbajtur këtë mbledhje është një rregull që KEK-u në ndërkohë, e ka shpall dhe i ka detyruar bizneset që me një formë të vijnë dhe të kualifikohen për të qenë konsumatorë me prioritet.

Nuk dua të përsëris, sepse do të përsëriteshin shumë nga ato që tha ministri, pra, një prioritet i tillë është caktuar vitin 2005, kur praktikisht ka pas edhe më shumë mungesa të energjisë se tani, dhe është menduar, mu ashtu siç u tha që, bizneseve t'ju ... mos të ketë asnjë ndërprerje drastike, të cilat esencialisht e kanë dëmtuar shumë prodhimin, në ato kapacitete prodhuese e përpunuese që kanë qenë atëherë, aktive.

Dhe, duke parë atë politikë të Qeverisë, për t'ju ndihmuar bizneseve është bërë një rregull atëherë dhe disa kriteret, të cilat është dashur t'i plotësojmë të gjithë ata konsumatorë, në këtë rast, biznesorë ose ne i quajmë “disa industrial” disa i quajmë “komercial” por, sidoqoftë jo shtëpiak. Ka qenë krejt vullnetare dhe konsumatorët që i kanë plotësuar kërkesat kanë mundur të aplikojnë dhe ta fitojnë atë prioritet dhe ashtu kanë vepruar shumica prej tyre, dhe tash është viti i 2-të, kur unë e kam vërejt që 6 vjet në batim, domethënë është zbatuar aq sa ka pasur mundësi, sepse në kohën kur Kosova ka mungesë të energjisë elektrike në total, pra është gjithsesi, me ... importuese të energjisë, shpeshherë pa rezerva të

mjaftueshme edhe për kapacitetet që mund të bien rusisht ose aksidentalisht nga prodhimi.

Furnizimi me prioritet është një luks, faktikisht dhe atë duhet ta dinë edhe bizneset që momentet kur ka mungesa të mëdha të energjisë, furnizimi i tyre me prioritet nuk është që nuk i prek konsumatorët tjerë, gjithsesi i prek.

Ministri nuk e përmendi, por unë dua ta përmend që KEK-u është furnizues publik, pra prej furnizuesve komercial, tregtar në tregun e hapur. KEK-u është i obliguar me ligj, ta bëjë furnizimin e të gjithë konsumatorëve të Kosovës, pa dallim. Është obligim ligjor dhe atë duhet ta bëjmë para gjithash pa diskriminim, atë energji që e ka duhet t'ua tregojë gjithë konsumatorëve, konform rregullave, ligjeve, standardeve që ekzistojnë, të gjitha ato janë të aprovuara. Qoftë nga legjislacione primare, qoftë nga legjislacioni sekondar.

Dhe, këtë patjetër KEK-u duhet të sillet konform atyre rregullave. Konsumatorët janë të gjithë të barabartë edhe ai që ka vetëm një trafik, edhe ai që ka industri, në fund të fundit, secili jeton prej biznesit të vetë dhe ata duhet të trajtohen njësoj. Pse duhet të jetë dikush më i barabartë, se i barabarti ? Ajo kushton , nëse këtë tjetrën nuk duam ta premë. Ne kemi reaguar në momentin e dytë, andej kur faktikisht janë shpallur kriteret e reja për marrjen e një prioriteti të tillë dhe natyrisht lidhur me këtë kanë reaguar, sepse prej disa prej tyre është dukur që është e papërbalueshme një sjellje e tillë për të pasur 24/0.

Unë e kam marr atë dokument shumë më vonë, e kam kërkuar drejtpërdrejtë dhe drejtorit menaxhues të KEK-ut, sepse një rregull e tillë, nuk na është drejtuar ne, ani pse ka qenë obligim, absolutisht. Është ligjore me çdo gjë, me çdo procedurë edhe e brendshme e KEK-ut, në relacion me konsumatorët, nuk mund të zbatohet as pa ardhur dhe pa u harmonizuar me zyrën e rregullatorit.

Ne e dimë që KEK-u është monopol dhe nuk edhe një tjetër KEK ku konsumatorët do ta zgjidhnin nuk e blejmë prej këtyre, por do ta blejmë prej një KEK-u tjetër. Përderisa, është monopol ai rregullohet dhe ne jemi rregullatorë dhe Kuvendi e ka vendosur një rregullator të pavarur që kujdeset për këtë punë.

Konform atyre detyrimeve dhe obligimeve, ne e kemi ndërmarrë masën që duhej të marr dhe që është krejt e ligjshme që KEK-u nuk mund ta zbatojë një procedurë, e cila është e harmonizuar dhe është, domethënë, mund të mos jetë kundër ligjit kur shikohet, por tani për tani, përderisa nuk është aprovuar ajo është në ekzistim dhe nuk mund të zbatohet.

Kishte dilema ajo është, unë e kam këtu të shkruar shumë saktë e mirë, kush lexon mirë shqip, asnjë dilemë nuk është se çka thuhet në te. Ne e kemi ndal që të mos aprovohet, ku mos aplikohet rregullorja e fundit, por në asnjë fjalë nuk e kemi

cenuar konsumatorët që e kanë siguruar atë të drejtë paraprakisht, sepse zakonisht dihet ... dhe nuk veprojnë.

Domethënë gjithë ata që janë të kualifikuar dhe deri tani i kanë përmbushur kriteret, të ashtuquajtur “A+” e thash më nuk po e quajmë “A+” por Lista e konsumatorëve me prioritet, ata mund të vazhdojnë t’i plotësojnë kriteret në bazë të kontratës që i kanë përderisa të mos ndryshohet ajo kontratë.

Ju e patë që KEK-u megjithatë në një fazë, ka vepruar drejtë dhe i ka kontrolluar edhe ata të barabartë si të barabartit, pra më të barabartë se të barabartit dhe fatkeqësisht ka has, praktikisht në çrregullime dhe në shfrytëzim të jo ligjshëm të ... nga shumë biznese, janë më shumë se 50% janë shumë biznese. Dhe, në atë aspekt ... dhe e kanë atë të drejtë edhe ligjërisht që me ata konsumatorë, të cilët në çfarëdo forme kanë abuzuar me energjinë elektrike t’i paraqesin dhe t’i ndërmarrim të gjitha masat ligjore që ata i kanë në dispozicion dhe ato janë shumë, deri te shkyçja e tyre totale nga rrjeti elektrik.

Puna tjetër është që unë mund të them që edhe pak është bërë më shumë zhurmë se që është dashur, sepse nuk është kjo punë shumë e madhe dhe nuk është diçka që ka prekur shumë konsumatorë përnjëherë. Është fry pak më shumë çështja, se që në esencë është, bizneset kanë vazhduar të jenë të furnizuara për aq sa ka energji, unë nuk e di kush i ka shkyçur paligjshëm, nëse dikush është shkyçur paligjshëm ata e kanë të drejtën e tyre legjitime të drejtohen te ne dhe ne jemi po ashtu autoritet që i zgjedhim kontestet mes të licencuarve dhe mes konsumatorëve dhe të licencuarve.

Dhe ne gjithëherë, me shumë kujdes i trajtojmë të gjitha kontestet në mes të furnizuesit publik dhe konsumatorëve, në këtë rast edhe mes atyre bizensorë. Unë mendoj që kjo çështje është absolutisht e rregulluar dhe unë pres që ndonjë kohë sa më të përshtatshme për KEK-un t’i sjell kriteret që mendon, se duhet t’i plotësojnë konsumatorët për t’i furnizuar ata me prioritet pa i dëmtuar konsumatorët e tjerë.

Edhe një cent, nëse unë konstatoj se ... primitiv do t’i prekë konsumatorët e tjerë unë atë ... nuk do ta lejoj. E tash, nëse nuk ka energji dikush duhet të furnizohet me prioritet pa i dëmtuar tjerët atëherë, konsumatorët duhet të dinë që atë muzikë duhet ta paguajnë, vetë e jo të tjerët për ta. D.m.th. duhet të paguajnë më herët që të sigurohet një sasi e energjisë për të që është në dispozicion gjithëherë, edhe kur ka mungesë të vogël edhe mungesë të madhe, ata gjithëherë kanë energji dhe një energji e tillë e ka koston qoftë që blihet paraprakisht kështu që sigurohet si “stand by” si gatishmëri ... dërguar në çdo kohë. E atë duhet ta kalkulojë mirë KEK-u dhe ta paraqes te ne dhe ne me kujdes do ta shikojmë çdo pikë, veç e veç, dhe një dokument të tillë natyrisht, një procedurë të tillë kur te konsiderojmë që është e zbatuar e gjithë ligjshmëria dhe nuk është diskriminuese për askënd do ta aprovojme në momentin e parë.

Kaq sa i përket pikës së parë, pra rreth çështjes së, për mos me zgjat më shumë. Nëse keni pyetje direkte unë jam i gatshëm ta them ndonjë shpjegim eventual. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, shumë zoti Hamiti!

Unë besoj që do të ketë edhe pyetje në Rregullatorin po ashtu, që ka të bëjë me çështjet e stimulimit të prodhimit të energjisë ripërtrishme. Ne kemi interesime të veçanta, unë kisha kërkuar nga zoti Gjokaj me një prezantim dhe pastaj përfaqësuesit tjerë. Fjalën e keni zoti kryetar!

ARBEN GJOKA: Faleminderit zoti kryetar!

Përsëritet për ju dhe gjithë deputetët e pranishëm, Ashtu kisha dashur të përsërites ministrin Beqaj, profesor Hamitin, zotin Rukqiqi dhe zotin Shahini.

Me thënë të drejtën, unë nga ministri dhe mësuesi i zyrës rregullatorit ka vepruar gjerësisht, mua më mbeten vetëm disa kritere, si çështje teknike. Me thënë të drejtën KEK-u ka ... vetë furnizimin dhe siç e tha, profesor Hamiti, se furnizuesi ... në mision tregut si ndërmarrje publike e ka furnizimin e barabartë, pa diskriminim, të gjithë konsumatorëve të vetë. Mirëpo, duke e laboruar që më herët që është kuptuar që ... kryesisht prodhuese, kemi prioritet në rastet e efekteve dhe problemet teknike, të cilat nuk u drejtohen dhe ato gëzojnë një prioritet më të qartë që ne nuk kemi ndryshe ta quajmë, por i kemi quajtur “konsumatorë A+”.

Më lejoni të ju them se ka vite ose dy vjetët e fundit që shumica e konsumatorëve janë furnizuar edhe pse ka qenë në fuqi sistemi A,B,C janë furnizuar në mënyrë të rregullt. Nga viti 2009,2010,2011 ne kemi prej 13%, vitin 2008 që nuk kemi mundur të lëshojmë energji për konsumatorët e fundit, kemi zbrit në vitin 2009, shkakun që, ndërsa 2010 3%, dhe presim këtë vit në 2%, domethënë, që është një performancë mjaftë e mirë ...

Prapë se prapë, në rastet të defekteve teknike çka janë ... Kosova është një vend unik jo vetëm në regjion, por edhe në botë që e furnizon ose punon pa rezervë, për arsye se ne çdo ...që kemi punë ato i mbajmë, d.m.th. rezerva rezervë. Në momente të tilla ne detyrohemi që të importojmë energji, ju e dini se ndërmarrjet publike ju nënshtrohen Ligjit për ... dhe nëse i referoheni atij ligji mund të shihni çfarë krahore është të sigurosh energji brenda një ose dy ore, besoj se janë procedura të qarta rreth shumave ku dihet me bë, ne kemi gjetur në kuadër të ligjeve dhe në kuadër të emitimit të KRP-së dhe AKP-së, dhe gjithashtu BSHK-së, kemi dy vjet që preferojmë se për energjinë elektrike 1 vit, gjithashtu, i prodhojnë edhe 3 lloje të energjisë: energjinë emergjente, energjinë D dhe energjinë intra D.

Gjitha këto duke u thirr në çmimet, të cilat ... d.m.th. gjithherë duke respektuar ligjin dhe transparencën. Te këta konsumatorë nga ... përdoruesit janë zbatuar këto kritere, vetëm dallimi ku qëndron? Rregulli i vitit 2005 ka qenë 3 fatura, ndërsa me

rregullin e ri në qershor thuhet, nëse 25% të faturimit total, arsyeja është shumë e thjeshtë, ne kemi fuqi tarifa, të cilat janë të ndara në dy sezona, sezona e verës dhe e dimrit. Sezona e verës fillon nga marsi dhe zgjat deri në shtator dhe çmimi i energjisë është 50% më i lirë.

Nëse një biznes do të vinte në shtator dhe të kërkon të jetë kontraktues, atëherë në bazë të rregullit të vjetër të vitit 2005 është dashur që të ndajmë sirtarin e muajit qershor, korrik dhe gusht. D.m.th. i bie një X çmim, ndërsa nëse një biznes do të vinte në muajin prill, të kërkonte të jetë konsumatorë A+, atëherë ne bazë të atij rregullit është dashur ta marrim muajin mars, shkurt dhe janar që d.m.th. i bie 50% çmimit me balancë të ri...

Atëherë, ne për mos të bëjmë cenim ndaj këtyre bizneseve kemi vendos faturimin vjetor, përqindjen që është 25%, që i bie 3 muaj, por nuk i bie as verë as dimër, por i bie mesatarja e gjithë vitit dhe një mesatare rezulton që kanë një trajtim të barabartë.

E një kriter tjetër është e fundit, në vitin 2005 nuk ka pasur kujdes... sepse ka pasur prioritete tjera, ndërsa nga janari kemi bërë kontrollin sistematik të këto biznese, jo vetëm këto bizneseve, por të gjithave, por një grup i caktuar është marrë drejtpërdrejtë vetëm me këtë grup të bizneseve. Dhe, gjatë majit kemi hasur në parregullsi, të cilat veç u folën dhe nuk dua t'ju marr kohë më shumë.

Atëherë, ne ... e qesim atë kriter që humbjet teknike i merr përsipër KEK-u, humbjet komerciale në këtë rast, vjedhjet nuk guxojnë të jenë mbi 1%, nëse në atë dalje ka konsumatorë dhe identifikohen brenda muajit që ka humbje më të madhe se 1%, atëherë KEK-u ka të drejtë ta largojë nga A+ dhe ... konsumatori të gjendet defekti, pse është kjo përqindje?

Ndërsa, kriteri i fundit ka qenë, është direktiviti. Direktiviti është formë pagese, asgjë tjetër nuk është e re, është formë pagese, është forma më moderne, më e sofistikuar, forma që i parandalon ... fiskal, forma që parandalon shpëlarjen e parave dhe këto e aplikojnë çdo ndërmarrje botërore, evropiane, perëndimore.

Ne kemi hasur, se kemi pas shkëmbime të kostos, të cilat janë ndarë 7 muaj, serverë të ndryshëm, trajnim stafi që kjo formë e pagesës të jetë në fuqi, jemi ndërmarrje e vetme publike, nëse nuk gaboj tash, edhe ujësjellësi dhe disa ndërmarrje tjera veç kanë filluar ta aplikojnë këtë formë, nuk është haraç qysh e kanë interpretuar tjerët, por është formë pagese, sikurse është me orë KEK-u kur paguan sikur të shkonin në bankë, edhe kjo është formë pagese që bëhen përmes tri subjekteve të KEK-ut, si furnizues, Bankës Qendrore- shtetit dhe konsumatorit, i cili jep shënime për kredinë apo numrin e kontos ku dëshiron t'i tërheqim parat.

Fatura i shkon përmes sms, i shkon në formë elektronike përmes e-mailit dhe i shkon në formë fizike. E banka brenda 5 dite ka drejtë të njoftojë konsumatorin

nëse ka një faturë, një borxh e ki, nëse nuk e keni ndonjë vërejtje ose diçka ne mund ta bëjmë tërheqjen, nëse konsumatori ka vërejtje apo konteste vjen në KEK dhe i sqaron me departamentin në kuadër të kompanisë, kemi departament të veçantë për biznese, i cili merret kryesisht vetëm me këto biznese, d.m.th. trajtim të veçantë ju bëhet atyre edhe atëherë, mbas 5 dite banka e bën tërheqjen e parave ...

Këto janë tri kriteret, asnjë diçka tjetër më shumë nuk ka në këtë, rrjedhën e saj unë besoj që mundemi me laboru më shumë. Nëse ka pyetje specifike ne jemi të gatshëm për përgjigje?

Kemi qenë të befasuar të gjithë, sinqerisht, për arsye se ne kemi departament, kemi çdo distrikt, që e quajmë ne, ose çdo zonë kemi zyre që merret me konsumatorë, nuk ka pasur ndonjë ankesë të tillë, por ju referojmë që ka dalë në mënyrë publike ose përmes, mediave. Ne gjithëherë, çdo kërkesë të biznesit d.m.th publik edhe në ... ose në debatin që e ka ... nëse një biznes ka një kërkesë apo një, ta themi, kushtëzim nga ana e KEK-ut duhet ta themi publikisht, ku ka qenë dhe pse s'ka qenë?

Çdo biznes, në mënyrën më të sinqertë është trajtuar në mënyrën më të sinqertë brenda mundësive... Unë kam një listë të gjitha investimeve që ka bërë KEK-u së bashku me bizneset, por një numër i madh të bizneseve i ka bërë investimet vetë, flas për vitin 2007, 2008, 2009.

Viti 2007 më kujtohet në atë kohë ka qenë vit për të udhëheqë divizioni i shpërndarjes dhe kryesisht në sezonin e lartë në sezonin e dimrit, kur letra e bizneseve, i di me emra, kur kanë ardhur dhe janë lut që na t'i ndihmojmë, por ne e kemi një kriter që nuk guxojmë të bëjmë diskriminim përjashtim, krijohet një, vetëm ato biznese që kanë dalje të veqantë.

Prapë se prapë, ka raste p.sh. gjatë sezonit së veljes së rrushit, na edhe pse nuk e kemi të qartë me informuar në kohë të caktuar, kemi bërë përjashtime ku bëhen në bazë të procedurave gjithqka me qenë transparente, e jo një diskriminim dikush të favorizohet e dikush të disfavorizohet. Kryekput ose si përfundim i kësaj KEK-u ka pasur intensë që si qëllim që kjo rregullore t'i trajtojë gjitha bizneset, anekënd Kosovës në mënyrë të barabartë e jo të përfaqësojë një grup interesash apo një grup të caktuar biznesi.

Sa i përket, pjesa e dytë që dua të fokusohem është furnizimi momental dhe trimatit të planifikuar dhe përgatitjet që do të bëhen për sezonin e dimrit. Në sezonin e verës e fokusojmë në mirëbajtje, previzione gjitha pajisjet duke filluar nga, rrëmihja, gjenerimi dhe sistemi shpërndarës. Gjitha përgatitjet në gjitha divizionet janë përfunduar, kryesisht mundem me ju thënë që të jesh në depo të Kosovës, ... mbi 400 mijë tona, që presin të ekspaltohen ose të furnizojnë hyrjet

tona në Kosovën A dhe B, kemi 5 njësi të afta për punë, dy në Kosovën B dhe 3 në Kosovën A.

Gjatë vitit 2010, për shkaqe teknike dhe gjatë ekspaltimit, në vitin 2007 është vendos të blehen dy rotorë të shtypjes së lartë të turbinës, për informimin e juaj e turbinave gjeneratori në pjesë të mëdha, të ndjeshme ... të elektranave, pa prejashtuar asnjë pjesë tjetër, kur ato janë pjesë ku sforcimet dhe gjatë eksratimit janë më të mëdhaja se në pjesët tjera anësore, apo dytësore. Dhe në vitin 2007 është bërë prokurimi i tyre dy rotorëve dhe këta në vitin 2010 janë ndrruar në të dy njësitë, por gjithashtu gjatë vitit 2009 është bërë riprokurimi i një rotor-gjeneratori, për arsye problemeve se këto turbina janë vendos kah viti '83-'84 dhe prodhuesi apo firma e cila e bën monitorimin, e cila e bën inspektimin e përvitshëm, por për çdo 4 vjet e ka një inspektim, ne i thojmë “defektazhë totale” e jep udhëzime se si të përdoren këto pajisje për 4 vjetët e ardhshëm, për arsye se çdo 4 vjet ne bëjmë ndarje të sinkronizuar këtyre njërive.

Kjo bëhet për arsye se, ne kemi disa pajisje ose disa funksione, siç është: ..., furnizimi me ujë janë të përbashkëta dhe kërkohet që në çdo 4 vjet të bëhet një inspektim total, kjo ka qenë në vitin 2010 dhe të dy njësitë kanë qenë të ndara në mënyrë ... për 15 ditë, dhe te njësia B2, në korrikun e vitit 2010 prodhuesi i kësaj pajisje ka vërejtur edhe ka bërë kufizime gjatë operimit për 360 ditët e ardhshme. Ka dhënë rekomandime që në shtypjen e lartë duhet të ndërrohen diafragma, për shkak të problemeve në lëshimin e avullit që shkojnë në shtypjen e mesme, dhe ai ka thënë që: “ju duhet të punoni”, pra na ka caktuar shtypjen, temperaturën dhe në fuqi dhe e ka kufizuar turbinën të punojë në 240 m që ishte dashur, do të thotë, afër 270-280 V, pra afër 40 MW.

Dhe, ne menjëherë kemi marrë masa, kemi bërë prokurimin e asaj pjese, e cila pjesë, veç duhet ta kuptoni që është një pajisje shumë e madhe, nuk është pjesë që gjindet në treg, por ajo me porosi sipas ... prodhuesit. Mund ta lëmë datën 9 shtator, unë e kam shkruar një letër, e cila veq është publikuar në media, është 23 gushtit, ku i njoftoj të gjitha ... përfshirë edhe Kuvendi e Republikës së Kosovës edhe kam informacione që të gjithë deputetët e kanë atë letër, për hapat të cilat ne i kemi, nga 9 shtatori deri më 28 nëntor do të zgjatë ky remont i planifikuar 1 vit më herët.

Me përfundimin e këtij remonti, ne planifikojmë të punojmë me dy njësitë e Kosovës B, me kapacitet të plotë, mundem të ju them që nga pas lufta për herë të parë njësit e Kosovës B, është kthyer thuaja në fuqin origjinale ose kur është komisionuar në vitin '83 dhe presim nga ... që edhe njësia prej tyre ta arrijë atë fuqi që është 280-290 mega/h. Po flas, energji...

Dhe do të punojmë me dy njësi të Kosovës A, me njërin njësi alternim d.m.th. një rezervë e ftohtë në rastet kur temperaturat e ulëta që të mbulohen konsumin. Gjithashtu kemi marrë masa, se gjatë kësaj periudhe pjesa që konsumi ose që nuk

mbulohet nga prodhimet vendore të mbulohet me konsum nga importi, ku ne i kemi shpall tenderin vitin e kaluar dhe kemi nënshkruar kontratën në mars të vitit 2011 dhe kontrata vlen nga marsi i 2011 deri në mars të 2012.

Importi i kontraktuar nuk e mbulon tërësisht konsumin ose kërkesën, për arsye se kemi pasur edukimin në fondet shtesë, por për herë të parë si kompani, ne sivjet 15 milion euro do t'i ndajmë për import d.m.th. që pjesën tjetër që kemi marrë afër 27 milion euro nga Qeveria, pjesën tjetër e mbulon vetë KEK-u si kompani, kjo ndodh për herë të parë që procesi në vitin e ardhshëm do të mbulohet...

Këto janë në pika të shukrtëra, informacion i shkurtë. U mundova të jem më preciz për të mos ju marr kohë, për pyetje specifike, konkrete jam i gatshëm që...

(Ndërrhyrje)

KRYETARI: Faleminderit, shumë zoti Gjokaj!
Kisha lutur përfaqësuesin e Odës Ekonomike, zotin Rukiqi, e pastaj zotin Shahini.

BERAT RUKIQI: Faleminderit kryetar!
Të nderuar deputetë,
I nderuar ministër,
I nderuar profesor Hamiti,
Të nderuar përfaqësues të mediave dhe asociacioneve të ndryshme,
Është me rëndësi që sot është organizuar ky takim, të sqarohen të gjitha aspektet e kësaj problematike që është ngritur ditëve të fundit.

Ne si Odë Ekonomike e Kosovës e kemi një qëndrim zyrtar rreth kësaj dhe ky qëndrim zyrtar i është komunikuar KEK-ut, i është komunikuar Rregullatorit dhe Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, por pas një diskutimi publik me anëtarët e Odës Ekonomike të Kosovës, kryesisht të sektorit prodhues, pasi që ky sektor preket drejtpërdrejtë nga kjo çështje.

Në 3 vjetët e fundit, energjia elektrike nuk ka qenë “top” problem i bizneseve duke pasur parasysh që kemi një furnizim më të rregullt me energji elektrike, janë barrierat tjera, të cilat e pengojnë zhvillimin e biznesit, mirëpo jo edhe enegjinë elektrike edhe këtë herë edhe nga hulumtimet që janë bërë, viteve të fundit në Kosovë. Mirëpo, kriteret të cilat janë publikuar nga KEK-u në muajin qershor dhe të cilat ju kanë dërguar biznesit, pastaj janë bërë temë e debatit, për shkak se ka pasur paqartësi, jo pse ne vërejmë ndonjë dallim substancial në raport me kriteret që kanë qenë në vitin 2005.

Mirëpo, ka kërkesa të ndryshme të tyre dhe kërkesat orientohen në 3 pika. Pika e parë ka të bëjë me 25%, për shkak se kjo konsiderohet ngarkesë e madhe, tash ajo mesatarja dallon, te disa ndërmarrje mund të arrijë deri në 200 mijë euro, duke pasur parasysh situatën e vështirë financiare dhe fshehtësinë në qasjen e burimeve

financiare që i kanë bizenset, sigurisht një shumë e tillë është e papërballueshme, për një numër të madh të bizneseve dhe kjo kërkohet, kërkesa është që të zvogëlohet diku në 10%.

Nuk është problem direktiviti, direktiviti nuk është i obligueshëm, kjo është çështje që vendoset në kontratë, a donë me direktiviti apo duhet me shku me të pagesën drejtpërdrejtë, në sportelet që i ka KEK-u. Prandaj, nuk paraqet problem direktiviti, për shkak se është vullnetar nuk është obligative.

Çështja tjetër që është, është te identifikimi i humbjeve komerciale, këtu ka paqartësi, për shkak se biznesi konsideron që disa humbje komerciale nuk shkaktohen drejtpërdrejtë nga ata prandaj, këtu kërkohet një sqarim më i madh nga ana e KEK-ut.

Çështja tjetër, ka të bëjë me tarifat që nuk i drejtohet drejtpërdrejtë KEK-ut, mirëpo kjo është kërkesë për Rregullatorin. Bizneset mendojnë që gjatë dimrit janë tepër të ngarkuara dhe kjo drejtpërdrejtë ndikon në rritjen e kostos së prodhimit dhe rritja e kostos së prodhimit ka indikime tjera që i prek drejtpërdrejtë çmimet. Tash, sigurisht një pjesë e çmimeve lidhet me energjinë elektrike, tarifat më të larta kanë kosto më të lartë të energjisë elektrike edhe për qytetarët, mirëpo në të njëjtën kohë, tarifat më të larta kanë ndikim edhe në çmimet e produkteve që ne i konsumojmë çdo ditë dhe kjo pastaj...

(Ndërhyrje Ali Hamiti: Fatale është se tani gjithë vitin)

BERAT RUKIQI: Kërkesa është që të ketë një tarifë, mos të ketë dy tarifa...

(Ndërhyrje Ali Hamiti: 400 mijë konsumatorë janë, 400 mijë metodologji lypin)

BERAT RUKIQI: e qartë...

(Ndërhyrje Ali Hamiti: ne e marrim dhe ajo çka vjen prej KEK-ut, ata e dinë te na, kështu që sinjerisht, kjo është tepër detal për këtë forum, të diskutojmë për ...)

KRYETARI: megjithatë ju prezantoni një qëndrim të asociacionit tuaj dhe bizneseve që përfaqësoni dhe të njëjtën do ta bëjë edhe zoti Shahini.

BERAT RUKIQI: Do të vazhdoj edhe në pjesën tjetër, prandaj këto janë ato kërkesa që kanë dalur nga diskutimet publike. Ne i kemi dërguar edhe një letër, që ka qenë letër publike edhe për Rregullatorin edhe për ministrinë edhe për KEK-un që në asnjë mënyrë nuk bën të ndërpritet furnizimi për konsumatorët me prioritet, sidomos për ata që kanë kontrata. Çdo ndërprerje ndikon në ulje të produktivitetit, ulja e produktivitetit nënkupton më pak vende të punës, më pak eksport, më pak të ardhura.

Nëse e analizojmë rreth interesave komplet, ashtu siç punon KEK-u për interesa në publik, unë mendoj që në kuadër të interesit publik që duhet t'i përfaqësojë të gjitha institucionet është edhe ajo që këto ndërmarrje të sektorit privat, punësojnë njerëz, këta njerëz krijojnë të ardhura dhe këto të ardhura përdoren qoftë për kontribut, për buxhet nga i cili buxhet subencionohet KEK-u qoftë për pagesë të energjisë elektrike.

Kështu që çdo ndikim në punësim, çdo ndikim në ulje të produktivitetit do të ketë pastaj implikime negative që mundën të reflektohen. Prandaj, nëse analizohet interesi publik do të duhej të analizohet prej këtij këndi të efektit zinxhiror që mund të ketë dëmtimi i sektorit privat në këtë rast.

Këto janë qëndrime zyrtare të Odës Ekonomike pas disa kërkesave specifike që i kemi pas nga bizneset, pas dëgjimit publik po mendoj pas diskutimit publik që e kemi pasur me ministrin dhe drejtorin e KEK-ut. Kështu që për çdo pyetje tjetër, për çdo sqarim, për çdo detal ne jemi këtu sot, prandaj edhe njëher ju falenderoj për mundësinë që na është dhënë. Sigurisht edhe zoti Shahini, do të vazhdojë ato profesionimet që i kanë bizneset dhe pastaj, do ta keni një pasqyrë më të qartë rreth këtij problemi. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, shumë zoti Rukiqi! Zoti Shahini!

AGIM SHAHINI: I nderuari kryetar zoti Pajaziti!

Deputetë të Parlamentit të Kosovës,

I nderuari ministri Beqaj,

Profesor Hamiti, zoti Gjukaj, zoti Rukiqi,

Të nderuar përfaqësues të mediave,

Zonja dhe zotërinj,

Aleanca Kosovare e biznesit në pjesën e dytë të gushtit ka bërë një aktivitet nëpër bizneset e ndryshme në territorin e Kosovës dhe ka has te disa probleme që i kanë ngritur bizneset dhe një nga ta ka qenë problemi kryesor KEK-u dhe energjia elektrike. Do të thotë, ndërprerja dhe vendimi apo njoftimi i ri, i cili KEK-u e ka dërguar tek bizneset, të cilat kanë qenë me prioritet që sipas vendimit të vitit 2005.

Pas disa diskutimeve me bizneset, ne kemi parë të arsyeshme, se një vendim i tillë është ngarkesë për bizneset dhe ne këtë e kemi quajtur “vendimin e KEK-ut, njoftimi i KEK-ut në kohën e gabuar”. Pikërisht, kemi thënë, për çka? Sepse, masat e reciprocitetit treguan një rezultat të mirë dhe gjitha bizneset prodhuese ngritën edhe prodhimin, por edhe biznesin. Gjatë kësaj kohe asnjë biznes nuk është ankuar që nuk ka shitje apo asnjë qytetarë nuk është ankuar që ka mungesë të produkteve dhe kjo duhet tu falenderojmë bizneseve për fleksibilitetin që kanë treguar për t'i furnizuar qytetarët e vetë.

Pikërisht, në këtë kohë erdh një vendim që mund të ngadalsojë këtë hov të biznesit vendor dhe pjesa tjetër, pse kemi thënë të gabuar? Sepse, Qeveria në anën tjetër

promovon klimë më të mirë për bizneset vendore, anën tjetër KEK-u e merr një vendim tjetër që është në kundërshtim me parimet e Qeverisë.

Ne nuk e kemi kundërshtuar, ne i kundërshtojmë jo vetëm 3 pikat, por i kundërshtojmë pikat 2,3,4,7 dhe 8. Para jush keni ju një njoftim të vendimit dhe ne nuk jemi kundër “A+” por, jemi kundër vendimit, i cili nuk është marrë në harmonizim në Zyrën e Rregullatorit dhe në institucionet shtetërore që ne kemi pa që ka bërë një lëshim nga KEK-u. Prandaj, para se të ju dërgojmë ankesën tonë tek Zyra e Rregullatorit ne kemi dërguar një ankesë edhe tek ministri Beqaj, paraprakisht, dhe ju të nderuar deputetë e keni krejtësisht materialin nga dita e parë se si ka shkuar rrjedhoja deri te reagimi jonë.

Prandaj, nëse i referohemi njoftimit, thotë: “KEK-u i furnizon me energji elektrike por, nuk i siguron energji elektrike 24 orë dhe është në pikën e parë konsumatorët me prioritet nuk i nënshtrohen reduktimeve të kontrolluara që ata, të cilët janë biznesit, të cilët kanë nënshkruar këtë kontratë, ose do të nënshkruajnë një kontratë të ardhëshme, do të thotë, të kontrolluara nuk i nënshtrohen, të pa kontrolluara po, d.m.th. 24 orë prapë të ketë siguri për energji elektrike. Anën tjetër i kushtëzon konsumatorët që të jenë të kyçur në linjat e veçanta për 10 kB dhe kush investon aty? Mesiguri që biznesi, kjo është një kusht për biznesin.

Anën tjetër, të kërkojnë 25% garanci pagesë dhe kjo është një ngarkesë, pse them që është një ngarkesë? Sepse, bizneset duhet të shkojnë në bankë t’i marrin paratë, banka e ka një interes shumë të madh dhe këtu besoj që nuk është interes i KEK-ut t’i ngarkojë bizneset edhe me një interes që të shkojnë bizneset ta jepen këtë garancion, i cili do të jetë përgjithmonë në dispozicion të KEK-ut.

Pjesa tjetër, e cila thotë: “duhet t’i nënshtrohet direkt debitit”. Pse? Nëse e ka garancionin 25%, pse tash t’i nënshtrohen edhe një rregulli tjetër? Ky vendim ne kemi menduar që është në kundërshtim njëra me tjetrën. Anën tjetër, thotë, se: “në rast, vetëm njëherë dështon me pagesë mujore e humb përgjithmonë të drejtën që të jetë konsumatorë me prioritet në KEK”, mendoj që kjo është kundër të drejtave të njeriut, pse? Njerëzit e vrapojnë njeriun dhe pas vuajtjes së dënimit ai gëzon të drejtat si të çdo qytetarë tjetër dhe nuk sanksionohet që të jetë ai i privilegjuar nga të drejtat si person për të jetuar në qytetë.

Anën tjetër thotë, se: “nuk lejohen më shumë se 1% humbje” ne kemi thënë, pse të lejohet 1%? Nuk ka nevojë, le të bën atë infrastrukturën që mos të ketë humbje hiq dhe kemi thënë se: ne si Aleancë e Biznesit, ne nuk jemi për t’i mbrojtur ata që nuk paguajnë edhe ata që e keqpërdorin, por ata që e paguajnë dhe ata, të cilat kërkojnë energji elektrike 24 orë.

Ne këtë vendim të KEK-ut e konsiderojmë, si vendim unilateral kundër parimeve të konkurrencës, nuk garanton parim të reciprocitetit 24 orë rrymë, imponon disa rregulla që bizneset nuk kanë zgjedhje tjetër dhe ky vendim duhet të jetë i bazuar

në logjikë dhe jo në morfolë. Prandaj, kërkesat tona, të cilat janë adresuar në të gjitha institucionet relevante, kanë qenë që të anulohet një njoftim i ri dhe të diskutohet me institucionet shtetërore të ministrisë, KEK-ut, përfaqësuesit e biznesit dhe me bizneset, të cilat duan t'i nënshtrohen kësaj rregulle dhe të gjindet një modalitet i ri, për riformimin e kushteve të reja.

Këtu po duket, se ky vendim nuk është diskutuar paraprakisht me askënd, por është marrë në këtë formë siç është marrë. Anën tjetër, zoti Gjokaj tha se: “ne jemi për t'i trajtuar të gjitha bizneset e barabarta” pajtohem me këtë, por në anën tjetër bien në kundërshtim me vetëveten kur thotë, se: “ne nuk mund t'i trajtojmë problemet e një grupi të biznesit” pse? Nëse duhet të trajtohen të gjitha, trajtohen edhe ato individuale edhe ato grupe, për ata janë asociacionet e biznesit, të cilat grupojnë biznese të ndryshme rreth vetës dhe ne llojmë për ta. Ne jemi zë i biznesit, avokat i biznesit.

Prandaj, gjitha akuzat, të cilat kanë qenë në drejtim të Alencës së Biznesit nga përfaqësues të KEK-ut, mendoj kanë qenë që të emocionuara, të hidhëruara dhe kanë tentuar që ky njoftim përmes akuzave të kalojë. Organeve ... nuk e ka bërë këtë, për shkak se Aleanca e Biznesit e ka bërë një kërkesë për anulim, por për shkak se ata ligjërisht kanë pasur të drejtë, ose siç u tha edhe më ndryshe. Prandaj, ne jemi për rrymë 24 orë, bizneseve me prioritet, të gjindet modaliteti, por jo ngarkesë dhe bizneset nëse ato pajtohen, le ti paguajnë edhe 100%, por le të garanton Kek-u që do të ketë rrymë 24 orë.

Në asnjë formë, këtu nuk garantohej sipas kësaj 24 orë rrymë, përpos që garantohej që nuk mund, do të kenë reduktime të kontrolluara. Këto reduktime kohëve të fundit janë, shumë aktuale për shkak të Kosovës B, e cila ka shkuar në remont, është dashur të shikohet mundësia, se a është dashur të shkon tash në remont apo është dashur pak më herët, apo kur? Mesiguri që KEK-u ka vlerësuar që tash është momenti, por mendoj se tash edhe pas 16-tit, ne do të kemi një konkurrencë të ashpër të importit nga Serbia.

Mendoj që kjo është një moment i gabuar, sepse bizneset do të detyrohen që tu nënshtrohen reduktimeve, nafta edhe më tutje mbetet një produkt i shtrenjtë, gjeneratorët prapë kërkojnë mirëmbajtje dhe ne besojmë, se KEK-u, ministria për Zhvillim Ekonomik dhe të tjerët, se kanë ndikim të gjejnë një alternativë që t'ju ndihmojnë bizneseve dhe këto ndihmesa të jenë në pajtueshmëri me njëra-tjetrën.

Prandaj, edhe njëherë them, se ne do të jemi krah dhe zëri i biznesit në çdo formë dhe nëse ne e kemi një ankesë, nga bizneset ne do të adresojmë tek institucionet, të cilat janë përgjegjëse. Ne nuk kemi adresuar ankesë në KEK, sepse e dimë se KEK-u nuk bien në këto politika, por në ministrinë dhe në organin për zbatim. Faleminderit zoti kryetar!

KRYETARI: Ju faleminderit shumë! Ju kisha kërkua me mirëkuptim, që në pjesën e dytë do të ketë pyetje e përgjigje, të jemi sa më të shkurtë! Edhe një çështje tjetër që, duhet ta... faleminderit shumë, për ndërhyrjet që janë të nevojshme tash!

Edhe një çështje, që mendoj që... e para sa I përket kësaj çështjeje, nuk ka qenë ideja kryesore kjo, kjo doli në momentin e fundit ideja që ta kemi ZRE-në dhe institucionet tuaja këtu bashkë. Por, meqenëse kjo doli tash, unë nuk po shoh asnjë, diçka që është e pamundur, përkundrazi do të jetë në frymën e... Është një proces me interesime të përbashkëta, të gjitha institucionet duhet një koordinim më i mirë. Mendoj që KEK-u duhet t'i drejtohet ZRE-së dhe po ashtu t'i kemi parasysh edhe politikat, që i ka Qeveria ndoshta se çka doni me stimulu, çka doni me pas prioritet e tjerë. Fundi fundit e ka një plan të zhvillimit, i cili duhet të jetë në... institucionet përkatëse duhet të jenë në zbatim të tij. Unë dëshiroj shkurtimisht, të di nga zoti Beqaj dhe zoti Hamiti edhe diçka, që u përmend këtu, që do të ketë një debat lidhur me tarifat, që do të japin... (ndërhyrje) ...më lejoni veç ta përfundoj pyetjen! Nuk e di tash se çka nënkupton kjo.

Qeverinë e kemi dëgjuar disa herë që ka përmend edhe në raport me relacionet e BE-së, që ka qëllim të stimulojë prodhimin e energjisë së ripërtëritshme, në kohën kur ne kemi nevojë të madhe për energjinë, në ndërkohë kemi edhe disa interesime të bizneseve në këtë plan. Unë me zotin Hamiti kemi pasur edhe një takim të veçantë për një çështje të veçantë. Ka një... njëri prej bizneseve me këta mullinjtë e erës, që veç është ndalë puna e tyre, ata janë ankuar në këto tarifat, por kemi informata që po ashtu në vende tjera ka interesime, në zona tjera për këtë lloj energjie dhe po ashtu për energji solare.

Dëshiroj të di zoti ministër dhe zoti Zamiti, a ka politika të qarta në stimulimin e këtyre ... e prodhimit të kësaj energjie dhe a ka interesime të nevojshme dhe a po bëhet punë e nevojshme nga institucionet tuaja që të bëhet stimulim.

Ju e dini që në vendet e BE-së edhe shtetet participojnë nga buxheti i tyre. Ne nuk i kemi ndoshta ato mundësi, por dëshirojmë të dimë pak më shumë në këtë drejtim. Faleminderit! Pastaj pyetjet do t'i kemi.

BESIM BEQAJ: Zoti kryetar, shumë shkurt!

Ministria e Zhvillimit Ekonomik ka trashëgu një strategji energjetike, e cila është e aprovuar në Kuvendin e Republikës së Kosovës dhe jemi të obliguar ta respektojmë atë strategji deri në momentin kur kjo strategji ndryshohet ose konsiderohet, që është e pazbatueshme. Dhe, në ndërkohë, ne jemi nënshkrues të traktatit të energjisë, që realisht kemi marrë obligime, edhe sa i përket burimeve të ripërtëritshme, të cilat e caktojnë edhe nivelin se sa duhet me pas energji të ripërtëritshme.

Gjatë këtyre ditëve është duke u diskutuar në nivel rajonal, çka nënkupton me strategji të ripërtëritshme dhe sa kanë gatishmëri venet e rajonit që t'i aplikojnë standardet e bashkësisë evropiane, në fazë tranzitore, sepse do të jetë relativisht

problematike, dhe duke marrë parasysh atë që thash më herët, që në Gjermani tani janë duke i rishqyrtuar këto pozicione. Do të thotë, kjo është një iniciativë. Javën e ardhshme do të ketë takim joformal të ministrave të energjisë të Evropës Juglindore, pastaj do të ketë ... tash do të jetë takimi i sekretariatit të energjisë, i cili gjithashtu, bashkë me komunitetin, do ta trajtonë këtë çështje, ndërsa sa i përket rregullave të cilat janë të përcaktuara për akreditim dhe licenca të këtyre ndërmarrjeve, këto shkojnë tek rregullatori.

Rregullatori e ka të caktueme formën ligjore dhe edhe për rastet individuale, ne si ministri kemi obligim të për të caktu politika ne nivel të Qeverisë, të cilat do të jenë favorizim sa më i madh dhe furnizim sa më i rregullt me energji elektrike. Çështjen e operimeve të përditshme dhe çështjen e rregullimit, si Rregullator i energjisë, do të thotë rregullatori e ka bashkë me Kuvendin, janë ata të cilët duhet ta bëjnë rregullimin edhe të tarifave edhe të formave të licencave dhe kjo është çështje e drejtpërdrejtë. Unë sa kam informacion, vendimi të cilin Rregullatori e ka marrë sa i përket mullinjve me erë dhe orientimet tjera janë të qarta, janë kushte të qarta të cilat ndërmarrjet duhet t'i plotësojnë.

Dhe, unë do të jem i gatshëm në emër të Qeverisë, që në çdo moment, kur shihet që ka shkelje të çfarëdo procedure në zbatimin e kritereve, të cilat nuk i ka caktuar as Ali Hamiti, as Ministria, por i ka caktuar, do të thotë, përmes Rregullatorit dhe Kuvendi, nëse nuk ka përputhje me këto rregulla, ne nuk mund të lëshojmë licenca të tilla. Prandaj, duhet t'i sigurojmë se cilat janë ato kritere. Nëse konsiderohet se kriteret janë të papërbalueshme, duhet me i sjellë ne Kuvend dhe Kuvendi duhet me i ndryshu ato kritere, në mënyrë që ne pastaj të veprojmë konform kritereve të reja të cilat janë prur në Kuvend.

KRYETARI: Faleminderit!
Zoti Hamiti!

ALI HAMITI: Shkurt shumë! Është mirë që e keni ngritë këtë, por për këtë më shumë bëhet diskutime akademike rreth burimeve të ripërtëritshme se sa esencialisht dhe funksionalisht bisedohet për këto në shumicën e rasteve që i shoh

...

Zyra e rregullatorit të energjisë, po edhe vetë Kosova është njëra prej shteteve në Evropën Juglindore më e pajisura me rregulla, rregullativë rreth burimeve të ripërtëritshme. Ani pse është një prej më të varfërave me energji të ripërtëritshme, fatkeqësisht, sepse nuk kemi burime ujore për centrale të vogla. Kosovës, menjëherë tre lumenj të mëdhenj i ikin në tri dete, de nuk kemi erëra të fuqishme, se s'jemi bregdetar dikund ose s'kemi ujdhesa ku fryen shumë erë gjithë ditën dhe ne të mund ta shfrytëzojmë atë erë. Për aq sa janë bërë hulumtime, kanë dalë që burime të ripërtëritshme nuk ka shumë në Kosovë, as burime të erës e as hidrocentrale të vogla. Ma po i shihni përditë që nuk kemi shumë ujë, sidomos jo verës. Ne kemi mjaftë firma të interesuara, që të ndërtojnë edhe burime me erë

edhe për ato lokacione, vende ku janë identifikuar si të mundshme për hidrocentrale të vogla.

Unë i kam këtu një për një dhe të gjitha janë trajtuar. Ne japim autorizim për ndërtimin e atyre kapaciteteve pa u vonuar fare, duke dhënë një tarifë që është stimuluese, e të cilën e ka... janë politika edhe të qeverisë. Ne nuk mund të veprojmë ndryshe, përveç se në bazë të strategjisë së aprovuar nga Kuvendi dhe politikave, vjet për vjet që i bënë dhe i lanson Qeveria në sektorin e energjisë.

Ne do t'i plotësojmë dhe me këto aplikacione që kanë ardhur te ne, ne jemi në vijë me qëllimet, me synimet që i ka dhënë Qeveria. Pra, ne kemi hidro të vogla, KEK-u i ka disa kapacitete të vogla, të cilat i ka dhënë edhe me koncesion dhe është UJMAN-i një 34 megavatësh, që po ashtu trajtohet si energji e gjelbër dhe ne edhe sivjet edhe në mot edhe më tutje kemi energji të ripërtëritshme, që i plotësojnë kushtet të cilat i ka përcaktuar Qeveria, vit për vit deri në vitin 2000. Ne besoj që do ta arrijmë 2000-shin, 20, 20, 20, që është (ndërhyrje: tri njëzetëshe), tri njëzetëshe, që është reduktimi i... do me thënë efienca të ripërtëritshme dhe zvogëlimi i humbjeve.

Kështu që, unë kam këtu edhe... por, s'dua të ju lodhi me plotë firma që kanë aplikuar. Disave iu kanë dhënë autorizimet e lëshuara, autorizime preliminare dhe aplikacione që janë në përpunim e sipër.

Zakonisht, kur janë shumë më ambicioze se që i ndërtojnë, ne jemi të vetëdijshëm që këto kapacitete vijnë me marrë lejen, e me marrë farë kredishë e... nganjëherë disa fillojnë ndërtimin e disa s'i ndërtojnë kurrë. Kemi përvojën e Shqipërisë e përvojën e shteteve të tjera, që kanë dhënë autorizimin edhe me mija MW dhe nuk janë ndërtuar ende. Në Shqipëri as tri sa te na në Golesh, nuk janë ndërtuar, krejt tri fluturake, që po i thoni..., por, do me thënë, ne praktikisht kemi legjislacionin më të përparuar dhe në frymën e direktivave evropiane për burime të ripërtëritshme, mos e keni merakun. Ishalla vijnë e ndërtojnë, e qatë erë sa të fryjnë e shfrytëzojmë!

Vetëm një gjë të ju them, Gjermanët, sa kanë qenë të gjelbërit në pushtet, francezët kanë ndërtuar centrale nukleare, ata kanë thënë, jo, po ndërtojmë mulli të erës, dhe, prej 20.000 MW, nja 3% të tyre i shfrytëzojnë, sepse s'ka erë. Ju bjen me udhëtua prej fundit të Gjermanisë e në fillim, krejt autostradën e kalon... të gjitha fluturaket janë ndalë, sepse s'ka erë. As fletët s'lëvizin, e le ma... Do me thënë, janë të pasigurta edhe ato, fryn era... (ndërhyrje) ... jo, era fren se zoti e çon edhe këtë, kur fryn, por s'ju fryn. (ndërhyrje... të qeshura)

Kështu që, dua të them që, do t'i trajtojmë të gjitha që vijnë me mirëdashje sepse kemi interes. Sa më shpejtë që të jetë e mundur, edhe centralet e vogla edhe ato me erë. Me diell, e përmendët solare, vijnë... unë t'ju them të drejtën, të ju informoj këtu, vijnë plotë me kërkesa nganjëherë qesharake, edhe nganjëherë edhe diaspora jonë me biznesmenë të ndryshëm, që deklarohen, që më kujtohet njëherë, kush

është i Vitisë këtu pari... ju jeni, dikush, (ndërhyrje: s'e kam larg), se ke larg, ka pas ardhë një komision me dy-tre vet, thanë: - Po i bëjmë nja 200-300 MW me erë dhe Kosova duhet prej krize, sepse me erë prej Vitisë po e mbajmë krejt Kosovën". Dua me thënë janë thënie krejt arbitrare krejt fantazira... Energji do të ketë, është e vogël për 8 orë të kemi "back up" gjithmonë. Duhet edhe përgjithësisht them pak minit me i lanë edhe maçorin mbas derës, eventualisht me ia ngjitë për... qafë. Pra, ne duhet praktikisht me pas energji tjetër, "back up" sa herë s'fryn era. Ke ... (5:13:47), u kry, zoti e naltë nesër... s'i ke 100 MW, çka me ba... duhet dikund me i pas ato. Ajo është kosto pra.

Por, çmimet janë për energji të ripërtëritshme, janë të përcaktuara, janë inventive. Ata që duhet të ndërtojnë janë çmimet edhe për energji të erës edhe për biomasë edhe për hidro të vogla. Për energji diellore jo, sepse, ne e kemi ba, kur t'i harxhojmë këto që kushtojnë më lirë e provojmë me i mbushë të tjerat edhe me energji të diellit. Kaq.

KRYETARI: OK. Faleminderit shumë, zoti Hamiti!

Unë... Inicuese për këtë pyetje ishte një letër që na ka ardhur disa herë nga një kompani, e cila ka pushuar së punuari, për shkak të shkyçjes nga KEK-u dhe për shkak të tarifave (një ndërhyrje...) ... më falni ta përfundoj, edhe ne shpresojmë, ne na i kanë dërguar kopjet e letrave, të dyja që na i kanë dërguar, dhe ata kanë, minimumi herën e fundit që kan pas kërkuar, ka qenë që ju të ju përgjigjeni. Unë mendoj që institucionet si ju duhet t'i sqaroni qartë edhe ata që janë të interesuar, në mënyrë që nëse ka ndonjë biznes, i cili nuk ka mundësi, qoftë natyrore të erës të mjaftueshme siç është, e të tjera, të paktën t'i njoftoni me kohë. Unë po mendoj që duhet të kalojmë në pyetjet e kolegëve të mi.

(ndërhyrje: jo unë jam ...)

Unë kisha kalu në pyetjet, zonja Selmani, së pari një pyetje, pastaj kush don tjetër. ... u lajmëru e para.

MYZEJENE SELMANI: Faleminderit, kryetar!

Përhëndetje për ministrin, për kryetarin e bordit të Zyrës së rregullatorit, për ... apo Aleanca Kosovare e Bizneseve, njëra e Odës Ekonomike tjetra Aleanca Kosovare e Biznesit dhe ... duke marrë parasysh se unë si deputete e Kuvendit të Kosovës, duhet t'i drejtona ministrit për politikën e sektorit të energjisë, në aspektin ... dhe ministrit si i zgjedhur i kryeministrit, atëherë, politikën e mia shkojnë, (ndërhyrje: edhe i qytetarit), në aspektin politik dhe jo në aspektin menaxhues.

I dëgjuam dy determinet, edhe nga ministri i Zhvillimit Ekonomik dhe nga drejtori i Zyrës së Rregullatorit të Energjisë, i cili është i obliguar në bazë të ligjit për Zyrë për Rregullatorin e Energjisë, t'i përgjigjet Kuvendit të Kosovës, sepse është organ, i cili është formuar nga Kuvendi i Kosovës dhe njëkohësisht llogaritet si

agjenci e pavarur, e cila zbaton ligjin për Zyrën e Rregullatorit të Energjisë. E gjithë esenca gjatë këtij diskutimi u pa se, KEK-u dhe politikat e Qeverisë dhe Ministrisë së Zhvillimit ekonomik është i obliguar të bëjë furnizim të barabartë për të gjithë konsumatorët. Sa është reale furnizimi i barabartë për të gjithë konsumatorët, kur akoma kemi planin A, B, C. Ndërsa, çështja se si do të zhvillohet sektori i energjisë deri në fund, ministri e bëri një prezantim, dhe është i obliguar në bazë të ligjit të ndërmarrjeve publike, ministri Beqaj, që të na tregojë çka ndodhë në politikat e sektorit të energjisë, për arsye se i takon plani i Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, mirëpo, këtu duhet të kërkojmë që, dihet saktë se çka është furnizimi alternativ, kemi akoma ...

Bizneset furnizohen me kategorinë A+. Askush nuk është kundër furnizimit të bizneseve me kategorinë A+, në rast se ka prodhim për të gjithë qytetarët e Kosovës dhe ministri është në dijeni mjaft mirë se me çka përballohet KEK-u që dhjetë vite pas luftës, jo vetëm ky ministër, por të gjithë ministrat e sektorit të energjisë kanë pasur problem me KEK-un, për arsye të gjetjes, çfarë është gjetur KEK-u mbas procesit të përfundimit të luftës dhe për arsye të importit të shtrenjtë, jemi detyruar çdo herë nga ky buxhet i varfër i Kosovës, t'i ndajmë KEK-ut për import.

Rezerva u pa që s'ka, se na i kemi këto blloqe çfarë i kemi dhe, kisha kërkuar nga ministri, se është përgjegjës për politikën e Zhvillimit Ekonomik të sektorit të energjisë, çdo njoftim që bëhet në favor të bizneseve për furnizim me kategorinë A+, t'i drejtohet Zyrës së Rregullatorit si organ i pavarur, që për këtë arsye edhe me pakon e ligjeve të energjisë, të cilat janë miratuar në këtë Kuvend, Zyra e Rregullatorit të energjisë është ajo e fundit që vulos për licencim, për çështjen e tarifave dhe për çdo gjë edhe në bazë të Rregullores së pushtetit të përgjithshëm, që obligon ligji për Zyrën e Rregullatorit të Energjisë. Dhe mos të quhet ndoshta "haraç", për arsye se ne jemi në gjendje çfarë jemi, që kur ... jemi të gjithë ... të bizneseve, pse nuk mund të jetojmë prej produkteve serbe, as prej produkteve tjera, të cilat vijnë në Kosovë, se standardi i qytetarëve të Kosovës është shumë i ulët për me përballu harxhime ekonomike, çfarë kanë tash, mirëpo të shkon në bazë të Ligjit të Zyrës së Rregullatorit.

Ministri është i obliguar në bazë të Ligjit të Ndërmarrjeve Publike, që të bëjë monitorimin e ndërmarrjeve publike, në këtë rast KEK-ut dhe ... , dhe obligohet që këtu të mos bëhet një shfrytëzim siç ka ndodhur me rastin e Feronikelit. Ju e dini që tash e keni bërë një kontratë, KEK-u e ka bërë një kontratë tjetër, e cila është më e favorshme në favor të vetë KEK-ut dhe në favor të qytetarëve të Kosovës, mos të ndodhë i njëjti rast edhe me këtë kategori A+. Duhet të paraqiten të gjitha bizneset të cilat kanë nevojë, të jenë në kategorinë A+, të bëjnë një kontratë me KEK-un dhe në rast se nuk e zbatojnë, ne kemi gjykatat, dhe gjykatat do të merren. Secili qytetar është i barabartë para aktit më të lartë të Kushtetutës së Kosovës. Dhe në rast se i shkel këto ligje dhe këto akte nënligjore, që i nxirrni ju, atëherë për atë

arsye na e kemi funksionale gjykatën. Nuk jeni ju të thirrur me bë politikë të ditës ... Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Zoti ministër,

Unë paraprakisht isha pajtuar me zotin Hamiti, që edhe pyetjet po ashtu edhe përgjigjet, të mos jenë shumë akademike. Diqysh në përputhje me përgjegjësitë që i kemi edhe kompetencat, sa më shkurtë.

BESIM BEQAJ: Ministria ... por dhe Qeveria është e obliguar për furnizim të barabartë. Dhe, mendoj që, për vetë faktin që kemi ardhur nga 13% reduktim në 7.3 me planin për 2% në këtë vit, do të thotë është drejtpërdrejtë kontribut i angazhimit të Qeverisë, por edhe i KEK-ut, edhe i Rregullatorit dhe të gjithëve, që të eliminohen të gjitha humbjet dhe ndërmarrja të jetë e përgatitur për vetëqëndrueshmëri ekonomike. Fakti që, në këtë vit i kemi 27.200.000 euro, subvencionim për import, plus pjesën e kategorisë sociale dhe që, vitin e ardhshëm planifikojmë që këtë ta zbresim në 13.000.000, është fakt që Qeveria ... buxhet, do të thotë në kornizën afatmesme të shpenzimeve, të cilën neve e kemi fut, se Qeveria është shumë e kujdesshme në menaxhim dhe në furnizim të paraparë por, edhe në përgjegjësi menaxheriale, të cilën e ka secili institucion veç e veç.

Sa i përket A+-it, besoj që ka qenë vendim i mirë. Jam shumë i bindur që është vendim i mirë, për shkak se u shpjegua në mënyrë shumë të saktë nga profesori Hamiti. U tha që ne, për të mos cenuar të drejtën e tjetërkujt për të furnizuar me energji elektrike, është paramenduar parapagimi, për shkak se duhet siguruar energji nga importi. Ju e përmendët Feronikelin.

Po ju them shumë qartë! Feronikelin sot, kontrata e Feronikelit, nëse bizneset, sepse kanë ardhur shumë biznese dhe e kanë trajtuar kontratën e Feronikelit te unë. Dhe, iu kam thënë, OK, a doni me hy me kontrata me kushte të Feronikelit? Sepse, nuk e kanë pas të qartë çka është kontrata e Feronikelit. Dhe, po ua shpjegoj: Kontrata e Feronikelit është, që kemi çmim shumë më të mirë të energjisë, dhe, përveç asaj kemi paralajmërim së paku tre muaj paraprakisht që, Feronikeli duhet ta bëjë te KEK-u për sasinë e energjisë, të cilën ajo e përdorë për 3 muajt e ardhshëm, dhe, për atë sasi ajo faturohet.

Nëse thotë, unë i dua në 3 muajt e ardhshëm 100 MW, ai do të faturohet edhe nëse Feronikeli nuk e përdor atë rrymë. Pra, ne nuk mund të hyjmë në marrëdhënie kontraktuale, me dikë për t'i siguruar energji dhe me na thanë ai në gjysmë të asaj, - a di çka, mu nuk po më vyen ajo energji, për shkak se ne hyjmë në obligime kontraktuale në raport me importin e energjisë. Prandaj, duhet të jemi të kujdesshëm kur flasim për kontrata të tilla, sepse kontrata e Feronikelit tash është jashtëzakonisht e favorshme edhe për shtetin edhe për KEK-un edhe për të gjithë. Dhe, unë jam shumë i kënaqur që kam pasur mundësinë bashkë me drejtorin, por dhe me Rregullatorin, ta diskutojmë në detale që gjërat do t'i kthejmë kontekst.

Prandaj, për këtë arsye e përkrahu me tërë gatishmërinë time edhe profesionale, por edhe postin të cilin e mbaj, A+-in, për shkak se është me rëndësi që ne këtyre ndërmarrjeve t’iu ofrojmë energji konform marrëdhënieve kontraktuale. Dhe, kur thuhet në 24 orë, vetëm të jemi të qartë, kur thotë që nuk i sigurojmë për shkyçjet e pakontrolluara. Për shkyçjet e pakontrolluara, askush në botë nuk mund ... (ndërhyrje, Ali Hamiti: më mirë është të themi “të paplanifikuara” jo të pakontrolluara) të paplanifikuara. Çka është kjo? Kjo nënkupton, që ne, do të thotë, asnjëherë nuk do të ketë A,B,C për ato. Nuk do të ketë shkyçje, të cilën e bën KEK-u. Por, në rast se bie sistemi, bie sistemi në Maqedoni, bie sistemi në Serbi, bie sistemi në Kosovë, sulmohet, ne nuk mund t’i sigurojmë, sepse është marrëdhënie kontraktuale. Prandaj, duhet të kemi parasysh, kur i themi dikujt që është garantim 24 orë, por jo nga fuqia madhore, të cilën ne nuk mundemi me e garantu askënd.

Sa i përket planit A,B,C. Është funksional gjatë këtyre ditëve, për shkak të remonteve dhe problemeve teknike, të cilat i kemi dhe ne besojmë, shumë shpejt... Dje ka qenë gjendja shumë keq, është marrë, huazuar energji, sot situata është më e mirë. Besojmë që pasdite do të kthehet në funksion dhe do të normalizohet. Por, do të bëjmë edhe import të energjisë. Për të bërë import të energjisë duhet me pas mjete financiare. Qeveria nuk i jep më KEK-ut mjete nga të planifikuarat, përkundër asaj bile ia kemi zvogëluar tash edhe pak ma shumë gjatë këtyre ditëve, ia kemi bërë edhe një stopim, sa i përket mundësisë për të imp... dhe që realisht kërkon, në mënyrë të drejtpërdrejtë, fuqizim më të madh të menaxhimit. Dhe, kjo është synimi jon. Dhe, kjo është jo vetëm politikë e Qeverisë, për t’i normalizu me të gjithë faktorët, partnerët ndërkombëtar.

Sa i përket përgjegjësisë të mia konform Ligjit për ndërmarrje publike, ministria krijon politika, të cilat përmes strategjisë energjetike i aprovon Kuvendi, dhe nga ky moment unë jam i thirrur dhe jam i obliguar që t’i respektoj këto gjëra, do të thotë, të cilat duhet të shkojnë në zbatim të kësaj strategjie. Deri tash jemi në komplet në linjë me harmonizimin e këtyre gjërave, dhe, po ju them edhe një herë është mirë që mos t’i shikojmë gjendjet momentale.

Sa i përket furnizimit, ne kemi marrë edhe masa tjera, do të thotë, që të gjithë qytetarët brenda territorit të Republikës së Kosovës, pavarësisht ku gjinden ata të kenë trajtim të barabartë, dhe kjo është në proces e sipër. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, zoti ministër!
Zonja Sahatçija, zëvendëskryetare e komisionit.

TEUTA SAHATQIJA - Përsëritet të gjithëve! S’po hi tash emër e për kry me ju përsëritet secilin, po e bëjmë më shkurtë.

Ministër, ju në bisedat e juaja thatë, që në pajtim me politikën e Qeverisë, duhet të stimulohet biznesi dhe politikat Qeveritare janë që të krijohet një ambient më i mirë për biznes.

Në anën tjetër, po e shohim edhe prej Zyrës së Rregullatorit të Energjisë, po e citoj ZRRE-ne, e cila thotë, që zbatimi i kësaj Rregulloreje është në kundërshtim me dispozitat të nenit 4.4 të Rregullës për kushtet e përgjithshme për furnizim me energji. Edhe që kërkohet ndërprerja e zbatimit të rregullave për konsumatorët me prioritet të KEK-ut. Qysh është tash kjo ndërlidhja në mes të favorizimit të bizneseve edhe kërkesës së ndërprerjes së rregullës së re të KEK-ut.

Edhe e dyta, desha të pak më tepër të di edhe për punën e distribucionit, për privatizimin e distribucionit. Mendoj që aty ka ngecë edhe, në qoftë se mundeni, shkurt të na tregoni edhe për distribucionin. A ka praktika prej Evropës apo prej botës, ku distribucioni i operatorit të vetëm energjetik, është në duar të kompanive private? Dhe, si janë procedurat apo projektet në lidhje me këtë? Shkurt!

BESIM BEQAJ: Faleminderit, zonja deputete!

Sa i përket vendimit të 2005-tës, atëherë nuk ka ekzistuar ... ka ekzistuar në vitin 2006. Rregullatori konform përgjegjësive të veta, ka konstatuar që duhet realisht të respektohet kërkesa ndaj Rregullatorit dhe ne kemi biseduar me KEK-un, dhe, KEK-u është i obliguar që ta bëjë kërkesën dhe të vazhdojë me procedurat për trajtim të furnizu... do të thotë për furnizim të konsumatorëve me prioritet.

TEUTA SAHATÇIJA: Do me thënë, kjo rregull një herë është... është ndalë, apo jo?

BESIM BEQAJ: Kjo rregull, për momentin, do të thotë sipas kësaj, kërkohet që të ndalet, mirëpo ne e kemi diskutuar edhe me profesorin, do të thotë ka një fleksibilitet, që ata të cilët realisht nuk kanë qenë paraprakisht, ne t'i trajtojmë si të tillë dhe, në ndërkohë KEK-u duhet ta respekton procedurën, ti çon kriteret dhe Rregullatori do t'i respekton.

TEUTA SAHATÇIJA: Një herë për një herë është jashtë!

BESIM BEQAJ: Jo s'është jashtë, nuk është jashtë. Ne do të vijmë ...

TEUTA SAHATÇIJA: ... po, atëherë që ka ekzistuar kjo e reja...

BESIM BEQAJ: ... atë që ka ekzistuar, do të thotë është në fuqi, ndërsa bizneset janë në procese, të cilat janë duke shkuar dhe për këtë arsye ne kemi diskutuar edhe me rregullatorin edhe me KEK-un, që automatikisht do të forcohet pozicioni i caktimit të rregullave, të cilat duhet t'i caktojmë nga rregullatori, sepse me këtë vendim do të duhej të ishte e mbyllur. Por, mendoj që është prioritet dhe profesori e tha shumë qartë. Edhe Arbeni e tha në pjesën e vet, se ne jemi të gatshëm për t'i

furnizuar me energji elektrike të gjithë ata, të cilët janë të gatshëm për me hy në marrëdhënie kontraktuale bilaterale dhe unë iu kam bërë thirrje të dy asociacioneve të biznesit: - “Thuani kriteret, të cilat ju konsideroni që janë atë pranueshme, të përballueshme nga ju, uluni me KEK-un, kjo është çështje e marrëdhënieve kontraktuale, KEK-u do ta dërgon pas diskutimit edhe me juve te rregullatori dhe nëse kjo... mund të aprovohet”, por ne nuk mund të hyjmë në marrëdhëniet kontraktuale, në mes të... sepse te fundi i fundit edhe KEK-u edhe kjo, janë biznese të dy palët. Tjetër është që kjo është ndërmarrje publike dhe ne tash angazhojmë mjete nga Buxheti i Kosovës, por, sikur kjo të mos ishte si e tillë, atëherë kjo normalisht do të duhej të merremi në mënyrë individuale, krejt të pavarur me këto... me këtë trajtim.

Sa i përket privatizimit të shpërndarjes si dhe te furnizimit, ne kemi obligim, e kemi pas obligim nga traktati i energjisë, që ta bëjmë ndarjen e përgjithshme të KEK-ut, i cili ka qenë një njësi dhe është ndarë në tri njësi. Janë rregulla, të cilat janë standarde evropiane, ndaj janë:

- KOS, që është transmision dhe operator, pra është për transmisionet ndërkombëtare, transite e gjëra...
- Është KEK-u, i cili në këtë rast është gjenerues, prodhues i energjisë, dhe
- Ndërmarrja KEC, që në këtë rast është ndërmarrja për shpërndarje dhe furnizim, e cila merret me furnizim dhe me shpërndarje të energjisë elektrike, që realisht është ndërmarrje e re e krijuar dhe që si e tillë, e re krijuar do të privatizohet. Privatizohet si shërbim, i cili ndahet nga KEK-u dhe i jepet ndërmarrjes tjetër.

Dhe, në këtë rast tash, ku është procesi? Për të hyr në marrëdhënie të këtilla kontraktuale, na vyen metodologjia e tarifave, na vyen ajo marrëveshja për blerje të energjisë, që thirret TPA, në mes të KEK-ut dhe KEC-it, por edhe KEC-it dhe investitorit të ardhshëm privat që do të bëjmë në “Kosovën e Re”, pra, janë të gjitha të lidhura me njëra tjetrën, në mënyrë që ne të kemi marrëveshje, e cila është afatgjate.

Distribucioni është në proces është hapur dhoma e informatave, janë përgatitur të gjitha dokumentet dhe ne jemi në proces. E kemi shpallur tenderin, në fakt RFB-në, apo kërkesën për ofertim, dhe presim tash reagimin e investitorëve, që të vijnë, me çfarë propozimesh ata vijnë për të hy. I kemi katër kompani, të cilat janë të selektueme, si të tillë dhe si Komiteti i Privatizimit, të cilin unë e kryesoj, takohemi në mënyrë të rregullt atëherë kur ka me u marrë vendimi.

Po ua them me përgjegjësi të plotë se Qeveria dhe komiteti i ka krye të gjitha punët e veta, tash gjërat janë do të thotë raport me... tek investitorët, sepse ata i kanë marrë dokumentet, të cilat janë bërë, atë duodeligjencën, apo analizën e gjendjes në ndërmarrje, janë duke analizuar këto, janë në dhomën e informatave dhe dëshiroj, meqenëse kemi media këtu, të bëjë edhe një thirrje tjetër publike, që ky proces është proces publik dhe dhoma e informatave është publike. Të gjithë njerëzit, të

cilët dëshirojnë me marrë informatat për sa i përket procesit, janë të ftuar ta vizitojnë dhomën e informatave, e cila i ka të gjitha informatat, që i shkojnë edhe konsumatorit. Prandaj, nuk ka këtu asnjë lloj tendence për fshehje të çfarëdo informacioni, sepse ato informacione janë në dhomën e informatave dhe dhoma e informatave është publike. Por, fatkeqësisht, po e them, shumë pak, shumë pak njerëz, shumë pak institucione, shumë pak profesionistë kanë shkuar dhe kanë vizituar dhomën e informatave, në mënyrë që të informohen nga dora e parë, por, janë informuar, do të thotë, më shumë në bazë të diskutimeve, të cilat bëhen nëpër kuluare dhe nëpër vende të ndryshme.

Pra, ju bëj ftesë publike, që të gjithë ata, të cilët dëshirojnë të dinë procesin edhe të realizuar, le të shkojnë në dhomën e informatave dhe aty i kanë të gjitha informatat sa i përket procesit të distribucionit.

Normalisht, si ministër, te raportet në përgjithësi, që i kam ndaj Kuvendit, unë jam i thirrur që gjithmonë në pyetjet tuaja, pa shtuar asnjë hap... unë mund t'ua jap juve informatat konform specifikave dhe kërkesave që ju i keni.

KRYETARI: Faleminderit shumë, zoti ministër!
Nëse ka prej kolegëve tjerë? Zoti Visar Ymeri.

VISAR YMERI: Faleminderit, Kryetar!
Ju përsëritet të gjithëve, edhe unë mos të hyj bash një nga një se do të hupij kohë. Kisha bërë një dy ose tri pyetje të shkurta që lidhen me shumë ato tema që u hapën këtu, por edhe problemet që janë duke u diskutuar, projekte që kanë interes të... demagogjike, nga ...

Po fillojmë me këtë procesin e privatizimit që u përmend në fillim të rendit të ditës, e tash që erdhi deri te pyetja, atëherë, kisha dashtë me ditë se çfarë analize ka bërë Qeveria, nëse keni bërë ndonjë analizë vështirësive që mund të dalin nga procesi i privatizimit, për shkak se ne e dimë, e veçanërisht këtu në rajon, do me thënë kemi edhe përvoja, që privatizimi i tillë çfarë mëtohet me distribucionin e ... dhe deputetja Sahatçija, kur një kompani publike, që ka monopol në furnizim, kalon në kapital privat, atëherë lindin shumë probleme, siç e kemi për shembull rastin shumë të freskët në Shqipëri, por edhe në Maqedoni, sikur në ngritjen e çmimeve të energjisë elektrike, po ashtu edhe në qasjen, atë që quhet qasje në energji elektrike për qytetarët e Kosovës, në përgjithësi.

Pra, ju po thoni që privatizimi do të jetë i mirë, dhe e keni planifikuar që do të jetë i mirë dhe i dobishëm për Kosovën, por unë po e qes në nivelin shumë të thjeshtë, çka me bë tash? Çka do të bëjë Qeveria në atë rast, apo a do të dilni në publik e të thoni, që tash kjo është përgjegjësi e kapitalit privat e ...

Kjo është çështja e dytë, që cilën dashta me e ngritë është me lidhshmërinë, që e përmendët tash në fund. Lidhshmërinë në mes të distribucionit, nesër në mes

“Kosovës së Re”, e cila po ashtu do të kalojë në kapital privat, së cilës do t’i bashkëngjitet, pra, siç është raportuar disa herë në media, edhe “Kosova B”. Pra, ky lloj kalimi i monopolit të gjenerimit është i energjisë elektrike, po ashtu në kapital privat edhe në rast se do të ketë dallime në çmim në mes të kostos, ta zëmë të prodhimit të kostos përmes së cilës, apo të cilën është e pranueshme për distributorin, që ta blejë energjinë elektrike, atëherë kush do ta mbulojë këtë kosto.

Kjo është një pyetje, mendoj, legjitime në rastin e Kosovës, për shkak se e dimë që “Kosova e Re” nuk do ta ketë koston e prodhimit ashtu siç e ka “Kosova B”, që e përmendi ky, që është 22 – 25 euro transit, do ta ketë shumë më të lartë. Natyrisht, që kjo bashkëngjitje e “Kosovës B”, e cila po bëhet, për mendimin tim, në mënyrë jo tërësisht ligjore, për shkak se në Kuvend strategjia, e cila është kaluar fillimisht nuk është kaluar me këtë, por edhe në mënyrë shumë, mendoj unë, edhe të pamatur ekonomike, për shkak se siç e thash po monopolizohet gjenerimi i energjisë elektrike. Kur kësaj t’i shtohet, po ashtu, tendenca për t’ia miratuar tregun edhe gjeneruesit, atëherë kjo e vendos Kosovën në një pozitë shumë të vështirë, për shkak se Kosova pastaj duhet që ta mbulojë atë çfarëdo dallimi potencial që mund të ketë, në çmimin e gjenerimit, në çmimin e blerjes apo shitjes së energjisë elektrike, e cila do të bëhet nga distributori.

Dhe, çështja e tretë, të cilën desha me e ngritë, është... vetëm edhe një fjalë, do të thotë, një përgjigje shumë të shpejtë! Ndoshta ka dalë në publik por unë nuk e di, është si të trajtohen disa konsumatorë të energjisë elektrike, të cilët dihet qartazi që nuk paguajnë energjinë elektrike, së paku deri së voni nuk e kanë paguar. Këtu e kam fjalën veçanërisht për qendrën turistike të Brezovicës, e cila deri vonë e ka pasur një borxh shumë të madh dhe nuk e di a i është shkëputur rryma elektrike atyre, apo jo? E di, që ka pasur disa tendenca dhe disa herë janë shkëputur, por nuk kam ... teknike.

Edhe çështja e tretë, do me thënë, që dua ta ngre është kjo çështja e negociatave me Serbinë në raport me energjinë elektrike, pra në të njëjtin, të cilin e ka dërguar drejtori menaxhues, e i cila na është shpërndarë edhe neve si deputetë. Në fund të letrës thuhet që, pjesa veriore e Kosovës do të shkëputet tërësisht nga furnizimi me energji elektrike, për shkak të mungesës së qasjes që KEK-u e ka atje. Dhe, thërret për një përshejtim të marrëveshjes për sa i përket energjisë elektrike në negociatat me Serbinë. Pra, çfarë marrëveshje pritni që do të dalë nga kjo, për shkak se ne e dimë se çfarëdo marrëveshje që do të arrini me Serbinë, ajo mund të jetë pak në favor të Kosovës, por nuk do ta garantojë shtrirjen e tërësishme të KEK-ut në pjesën veriore të Kosovës. Pra, cila është vija e kuqe, kisha thënë në këtë rast, e cila do të jetë e pranueshme për KEK-un si ndërmarrje publike dhe çfarë mund të na thotë ministri për këtë marrëveshje, do të thotë, deri ku kanë mbërri negociatat për këtë? Faleminderit!

BESIM BEQAJ: Visar, Faleminderit!

Meqenëse... unë jam i përcaktuar për ekonomi të tregut dhe që transformimet në ekonominë e tregut janë të dhimbshme, por janë të domosdoshme. Procesi i privatizimit të distribucionit është privatizim i shërbimeve dhe i pajisjeve për momentin ... edhe infrastruktura, si e tillë, sepse ka nevojë për investime kapitale në infrastrukturë, por, duhet ta kemi parasysh që nuk flasim për proces të privatizimit, por flasim për ndërtim të “Kosovës së Re”. Dhe, ky është dallim shumë i madh.

Kur flasim për ndërtim të “Kosovës së Re”, flasim për partneritet publiko-privat. Jo privatizim, qysh i adresohemi për çdo ditë!

Pse?

Sepse, futja e “Kosovës B” dhe mundësia e shtetit për t’ia dhënë mihjet, pra minierat, e bënë Qeverinë dhe shtetin e Kosovës aksionar në këto ndërmarrje, qoftë në gjenerim, qoftë në prodhim të energjisë elektrike, prandaj nuk flasim këtu për privatizim klasik, ku ne do t’ia japim dhe Qeveria nuk ka asgjë të bëjë me to.

Dhe, për këtë arsye unë kam përgatitur një, le të themi, një strategji të komunikimit, e cila do të lansohet shumë shpejtë, për të gjithë qytetarët, që të gjithë ta kuptojnë se për çka jemi duke folur. A jemi duke folur për privatizim apo jemi duke folur për transformim dhe realisht për partneritet publiko-privat.

Pse unë mendoj që është mirë? Sepse, shteti për momentin ka mungesë të buxheteve të veta për të përmirësuar infrastrukturën në mënyrë të shpejtë dhe nuk i ka këto mjete.

E ku dallon prej vendeve të rajonit? Po ju them që, si ministër, kam qenë në pozitë ku i kam diskutuar me të gjithë përgjegjësit e institucioneve disa vendime të cilat e dallojnë substancialisht, procesin e privatizimit të rrjetit dhe të furnizimit nga vendet tjera. Ajo është, që ne nuk i japim garanci investitorit paraprak për faturat e papaguara, qysh ka qenë ... Ne nuk pranojmë, do të thotë, që Buxheti i shtetit me qenë garant. Ne iu garantojmë investitorëve vetëm respektim të rendit dhe ligjit, dhe ata konsumatorë nuk e paguajnë, shteti do të jetë i obliguar me e respektua kontratat dhe për këtë arsye edhe ministri i Drejtësisë, na është bashkëngjitur grupit të ministrave që merremi me çështje ekonomike, që të kemi një qasje të përshpejtuar, sa i përket jo vetëm rasteve të energjisë, por në përgjithësi të gjitha rasteve të biznesit.

Është kërkuar me pas edhe një fond të veçantë, sikurse e kanë edhe shtetet tjera, ku pas procesit të privatizimit do të jetë një fond i veçantë, i cili në rast se krijon humbje për ndërmarrjen, e cila është në proces të privatizimit, apo e cila ka privatizuar rrjetin, do të mund t’i kthehet ai fond dhe do t’i merr ato mjete. Jo! Nuk ka garant në asnjë fond të tillë. Nuk ka garantim në asnjë fond të tillë, i cili atyre iu jep komoditetin, që ata mos me performu konform objektivave të tyre afariste. Por, do të jenë të shtyrë në garë! Dhe, në ndërkohë, është duke u përgatitur modeli i tregut. Realisht, është aprovuar modeli i tregut nga KOST-i, i cili në të ardhmen

parasheh edhe zgjerim të tregut, do të thotë, edhe eliminim të këtyre monopoleve, për të cilat po flasim. Jo, pse ne duam, do të thotë, në mënyrë të drejtpërdrejtë, por është kërkesë e traktatit të energjisë dhe realisht ne jemi të obliguar me e i respektua ato norma të cilat na ...

Tarifat të cilat duhet, sepse është diskutuar shumë dhe po diskutohet, profesori tha sa kemi mundësi ne që me dhënë, me zhvillu kapacitetet për energji të ripërtëritshme. Dhe, kjo është debat shumë i gjerë. Debat shumë profesional, i ndërtuar me tri subjektet.

Cila do të jetë tarifa? Dhe, kërkohet që, tarifa në të ardhmen të jetë shpenzimet e prodhimit të energjisë duhet të reflektojnë me tarifa. Jo që shteti me marrë obligim, që përmes buxhetit të vet me i mbulu, do të thotë, humbjet e çfarëdo ndërmarrjeje. Dhe, këtë kur e thash, që ne duhet ta harmonizojmë në mes të interesit për furnizim të sigurt. Furnizim të sigurt nënkupton që ne mund ta parashohim brenda vitit sa energji mund të kemi, sepse janë... nuk mund ta parashohim erën, që u përmend, por, mund ta parashohim, në këtë rast linjitin, dhe siguria e furnizimit të energjisë dhe mundësia e qytetarit për ta paguar atë energji, janë efekte determinuese, të cilat ne duhet me i pas parasysh kur flasim për ndërtime të kapaciteteve të reja energjetike. Jo, do të thotë, që të themi ne, sepse po e them, energjia solare, të gjitha energjitë tjera janë perfekte! Të gjithë kemi dëshirë që të jetojmë në një ambient të tillë por, kjo nënkupton që së paku 5 herë duhet me u rritë faturat për qytetarët tonë, sepse në shtetin..., ose duhet me i paguan shteti prej buxhetit dhe prapë i paguan qytetari, ose kjo duhet me qenë e reflektuar në faturë, që realisht e paguan konsumatori.

Prandaj, kur flasim për tarifa të energjisë ne duhet të jemi të kujdesshëm, do të thotë, jo vetëm të flasim në nivelin akademik, se do të ishte mirë me pas, por, flasim për impakte, sepse kemi përgjegjësi publike për impaktin, të cilin këto do ta kenë në faturat e qytetarëve, sepse te fundi i fundit, të gjithë prej nesh që jemi këtu, edhe ju deputetë, kur të fillojë implementimi dhe hapja e tregut, të gjithë do të jemi konsumatorë të rregullt, pa pozicionet të cilat ne duhet t'i mbrojmë sot, por, duhet paguar faturat e energjisë. Pra, e shohim këtë nga këndvështrimi i konsumatorit, nuk e shohim nga këndvështrimi i posteve dhe pozitave dhe politikave, të cilat i kemi sot. Dhe, kjo është obligim publik i secilit njeri të zgjedhur në postet publike.

Prandaj, kjo është arsyeshmëria, pse unë e kam trajtuar me kaq kujdes bashkë me të gjithë bashkëpunëtorët e mi. Sa i përket humbjeve të cilat shkaktohen në KEK, ne kemi marrë një qëndrim pra, në bashkëpunim me të gjithë akterët, që të gjithë konsumatorët të trajtohen në mënyrë të barabartë brenda territorit të Republikës së Kosovës. E thash parëz shkarazi, ju letrën e keni marrë, një letër e cila iu ka drejtuar institucioneve vendore dhe ndërkombëtare, përgjegjëse për këtë proces, dhe, normalisht ne do të zbatojmë politikën e reduktimeve energjetike konform planeve tona për t'i bindur konform kapacitetit energjetik, të cilin e kemi, pa marrë parasysh a janë ata në brendi të Kosovës, apo janë edhe në pjesën e veriut.

Dhe, ne do të jemi të determinuar, që të gjithë ata keqpërdorues, ato grupe kriminele, të cilat pretendojnë që të bëjnë çfarëdo lloj keqpërdorimi energjetik, në cilëndo pjesë të Kosovës, ai do ta merr dënimin e merituar, sepse nuk do të lejojmë. Kosova është një territor energjetik dhe si i tillë ne iu kemi qasur edhe procesit të privatizimit dhe si i tillë do të privatizohet dhe si i tillë Qeveria do të sigurojë që të gjithë qytetarët e Republikës së Kosovës do të kenë qasje të barabartë sa i përket respektimit të normave ligjore. Ka pas humbje, ato humbje nuk do të amnistohen, ato humbje do të adresohen aty ku e kanë vendin e vet. Por, janë çështje të cilat gjatë këtyre ditëve edhe KEK-u edhe KOST-i edhe Rregullatori edhe Ministria, janë duke u marrë në mënyrë aktive me te, në mënyrë që ne ta vëmë kontrollin e plotë. Ne e kemi furnizuar edhe pjesën veriore, nuk kemi inkasuar, por, me marrëveshje, sepse pyetët se cili do të jetë pozicioni i Qeverisë, pozicioni i Qeverisë është që, zbatimi i ligjeve të Republikës së Kosovës dhe i Kushtetutës së Kosovës do të jetë brenda territorit të njohur ndërkombëtarisht të Republikës së Kosovës. Ky është parim, të cilin askush nuk do ta ketë as nuk e ka orientimin por, as nuk do ta ketë mandatin me dalë nga këto korniza.

KRYETARI: Faleminderit shumë, zoti ministër.
A pati...? Zoti Gjokaj, nëse keni me shtu diçka.

ARBEN GJOKAJ: Faleminderit, kryetar!

Edhe një herë do ta theksoj, KEK-u e ka në parim të vetin, trajtimin e barabartë të të gjithë konsumatorëve, dhe sinqerisht e thirri çdo institucion, çdo individ dhe çdo medie, që nëse e vëren që një konsumator është trajtuar në mënyrë favorizuese apo diskriminuese, ta bëjë publike.

Këtu u përmend në mënyrë koncize ky rasti i Brezovicës, apo deri te Molika me tri resore që i ka, momentalisht ky hotel është i shkyçur, dhe është shkyç në vazhdimësi. Ka bërë një pjesë të pagesës dhe momentalisht ka 2000 euro. Nga maji, nëse s'gabo, konsumatori është i shkyçur. Për dijeninë ose për informimin tuaj korporata ka trashëguar një situatë e nga paslufta për mosshlyerje në gjithë territorin, kryesisht në pjesë ose zona ku janë quajtur enklava, por në bazë të planit i cili është detajizuar dhe është përkrahur nga gjithë mekanizmat vendor nacional dhe ndërkombëtarë, ne kemi pas shkrirje nga 13% humbje, që kemi trashëguar, momentalisht kemi vetëm 4%, ato që i përmendi ministri Beqaj, që janë të lokalizuara përtej lumit Ibër.

Edhe për atë pjesë ka plan veprimi. Ne jemi gëzuar nga institucionet, që t'iu japi shancë bisedimeve dhe shpresojmë që të ketë bisedime të suksesshme, siç e tha ministri Beqaj, bisedimet janë në kuadër të ligjit, ...

Ajo që dua të cekim te letra, që e përmendi i nderuari zoti Ymeri, duhet lexuar me kujdes, mos të ndahet në pjesë. Ajo është një letër informuese dhe pikërisht qëllimi i kësaj letrë është që ne jemi ndalu ose jemi interferu nga mekanizma kryesisht ndërkombëtarë, për moslejimin të shkrirjes në këtë pjesë, për shkak që tashmë e

shihni që janë politike më shumë. Ne e kemi kërkuar që ata ose dikush ta merr barrën e kësaj kostoje, ose ne do t'i trajtojmë si të gjithë konsumatorët.

Ministri Beqaj e tha shumë qartë, ne veç kemi filluar mekanizmin. Plan i është në zbatim e sipër. Por, prapëseprapë jemi për bisedime dhe zgjidhje paqësore të problemit. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, zoti Gjuka!
Zonja Shala e ka një pyetje.

(Ndërrhyrje e Visar Ymerit: M'u duk që u diskutua pyetja ime)

VISAR YMERI: Faleminderit!

Kur fola për tarifa, më shumë i referohesha, do me thënë, rritjes së kostos së gjenerimit të prodhimit të energjisë me ... "Kosova C" ose "Kosova B" se sa me energjinë e ripërtëritshme. Për aty, do me thënë, pakë a shumë u diskutua këtu, dhe mendoj se është shumë e qartë që Kosova mbase nuk i ka kapacitetet edhe atë, si të them ashtu, tërheqëse për me ndërtu kapacitete të energjive të ndryshme. Natyrisht, që bashkëpunimi më i ngushtë dhe integrimi më i ngushtë me Shqipërinë në këtë drejtim do të na ndihmonte shumë dhe kjo mendoj që, do të ishte ndoshta, zgjidhja më e mirë për sa i përket aspektit ambiental, por edhe furnizimit me energji elektrike.

Por, pyetja ime ishte, se si do të mbulohet dhe a do të ketë së pari, a planifikohet të ketë dallim në mes të mundësisë për ta paguar pagesën e energjisë elektrike nga konsumatori, duke pasur parasysh gjendjen në të cilën ... edhe rreth prodhimit apo rritjes së prodhimit për ata.

Edhe çështja e dytë është që, dhe që lidhet me këtë është që, ju thatë që nuk do të ketë kurrfarë garanca për privatizues, apo kompani privatizuese që e blejnë institucionin, por dhatë garanca në atë se a do të paguhet rryma elektrike 100% sa ata furnizojnë, dhe kjo natyrisht që pastaj rezulton në shkyqje të konsumatorëve individual. Për shkak se ata nuk mund ta kenë fare këtë aspektin e përgjegjësisë publike, që mund ta ketë sot kompania publike. Mirëpo kjo mund të rezultojë shumë lehtë edhe përveç shkyqjes edhe në burgim apo rritje të energjisë elektrike për ta mbuluar atë kosto, për shkak se ne e dimë që kapitali privat, po qe se vjen, vjen për përfitime, nuk vjen për me na ba mirë neve. Këtë e kemi të qartë të gjithë. Për me arrit atë përfitim ai do ta arrijë këtë në një apo në mënyrën tjetër. Pra, prapë po flas por... po i referohem rastit të Shqipërisë, kur në një moment, për shkak se Qeveria e Shqipërisë ishte kategorikisht kundër ngritjes së çmimit të energjisë elektrike, atëherë propozimi i CEZ-it atje, ishte që, mirë pra, na e paguani ju dallimin prej buxhetit. Pra, mbuloma ti profitin. Ose do ta marr prej këtyre, ose do ta marr në mënyrë indirekte prej qytetarëve nëpërmes buxhetit. A do të vijë, a do të jemi në kesi situatë në Kosovë dhe çfarë na garanton neve në planin tuaj, se nuk do të vijë një situatë e tillë këtu.

Për sa i përket do me thënë, marrëveshjes për veriun, unë mendoj që përgjigja që shpresojmë se do të jetë marrëveshje pozitive, nuk është e mjaftueshme, por pyetja ime është se çfarë është marrëveshje e pranueshme për KEK-un si ndërmarrje dhe çfarë është e gatshme, që të arrihet në treg pa emrin Qeveria. Për shkak se, tash po e dini ka qarkulluar shumë informata përmes mediave, asnjëherë të konfirmuara, se ka një mundësi që të krijohet një kompani atje e cila ose do të jetë kontraktuese me KEK-un dhe pastaj është pyetja se a do ti pronësojë ajo edhe infrastrukturën energjetike ajo kompani e re, e kështu me radhë. Këto janë pyetje në të cilat ishte dashur me u përgjigj qoftë KEK-u, qoftë ministria.

KRYETARI: Zoti ministër!

BESIM BEQAJ: Sa i përket harmonizimit me Shqipërinë. Ajo është duke ndodhur, ju them, është duke ndodhur, sepse është një projekt për ndërtimin e linjës 400 KV, që realisht është një kosto diku 75 milionë euro në Shqipëri dhe në Kosovë dhe e cila na mundëson këmbim jashtëzakonisht cilësor dhe optimalizim të rrjetës energjetike tonën me të Shqipërisë, sepse ne jemi afër 100% të bazuar në termo kurse ata janë afër 100% të bazuar në hidro, dhe pikët nuk janë të njëjta. Pra, realisht ky, ne kishim mujt me folë ditë e natë për harmonizim të sistemeve sikur të mos ishte nisur kjo procedurë, e cila na mundëson teknikisht sepse do të ishte e kotë, të themi me linjën 220 KV që ta bëjmë një këmbim të tillë.

Prandaj, ky është proces i cili është duke ndodhur, e kjo nuk shihet vetëm me Shqipërinë, por në aspektin edhe rajonal, sepse ne kemi edhe tri linja të tilla, por, realisht me asnjë prej tyre nuk kemi kompatibilitet energjetik, sikurse kemi me Shqipërinë.

Sa i përket çështjeve, do të thotë, të negociatave si të tilla unë thash qëndrimi final, të cilin e ka të qartë secili përfaqësues institucional i cili merret me atë çështje, dhe ajo është që çfarëdo marrëveshje e cila bëhet duhet të jetë në harmoni me Kushtetutën, me ligjet e Kosovës dhe me interesat e qytetarëve të republikës së Kosovës. Prandaj, kjo është vi e kuqe dhe ne nuk do të lejojmë asnjë lloj veprimi apo krijime të kompanive, të cilat nuk do ta respektojnë ligjshmërinë institucionale të republikës së Kosovës, nuk do t'i respektojnë institucionet e vendit, por kjo kërkohet... Prandaj, për detaje teknike nuk do të hyhet tash, por të jeni të sigurt që respektimi i kushtetutës, respektimi territorial, respektimi i zbatimit të ligjshmërisë dhe regjistrimeve të ndërmarrjeve dhe të gjitha elementet, tjera të cilat janë pjesë përbërëse elementare e zbatimit të ligjeve të një vendi, do të jenë të involvuara në këtë marrëveshje. Dhe, unë besoj që kjo do të jetë jashtëzakonisht pozitive dhe e fuqishme për vendin.

Ju e dini që KOST-i, duke parë që neve kemi pasur ndërhyrje të cilat nuk janë në harmoni me traktatin e energjisë, sistemet energjetike transite ka bërë një ankesë në traktatin. Në shkallën e parë është zgjedhur pozitivisht për neve dhe presim që kjo

të zgjidhet tash në takimin e radhës, që do të jetë në nëntor, ku shtetet kanë detyrim, shtetet anëtare të traktatit të energjisë për ta trajtuar këtë, sepse kemi shkelje flagrante të traktatit të energjisë.

Pra, jemi të përkushtuar dhe secili institucion është duke kryer punën e vet në mënyrën maksimale.

Sa i përket investitorit privat, vetëm duhet t'ua bëjë me dije një, se çfarëdo që të jetë investitori, qoftë privat, qoftë publik, e ka për obligim me iu nënshtrua rregullave të Rregullatorit dhe Rregullatori është ai që i përcakton tarifat dhe i përgjigjet Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Prandaj nuk ka mundësi dikush me ardhë me kërkim rritje të çmimeve të energjisë, për pa kaluar nëpër Rregullator dhe pa kaluar ... Rregullatori duhet me iu dhënë përgjigje.

KRYETARI: Faleminderit shumë!
Zonja Shala, e pastaj zoti Kelmendi.

SALA BERISHA: Faleminderit, kryetar!
Përshëndetje për të gjithë të pranishëm! Komisioni Parlamentar e ka edhe ashtu obligim ligjor, që së paku një herë në vit të organizojë këso seancash dëgjimore me faktorët relevantë, që janë të ndërlidhur me detyrat dhe obligimet e Komisionit Parlamentar. Por, kjo seancë dëgjimore ka ardhur pak si në mënyrën më të përshpejtuar, për shkak të provokimeve që ishin në lidhje me reagimin e bizneseve rreth kontratave me KEK-un, kategoria A+.

Sidoqoftë, është një takim i mirëseardhur. Është i mirëpritur! Së paku personalisht mendoj që, jam plotësuar me informacione prej faktorëve relevantë, që i kemi përballë këtu. Duke i parë ballafaqimet e argumenteve të tyre në lidhje me problematikën e fundit, unë do të përpiqem që të jem shumë e shkurtër në këtë drejtim.

U përmend disa herë, me të drejtë, se KEK-u ka obligim që të gjithë konsumatorët t'i trajtojë si të barabartë, megjithëse këtu na dalin edhe ... kjo çështje është pak komplekse sepse këtu kemi konsumatorë publik, konsumatorë privat, konsumatorë të ashtuquajtur amvisëri, e tjera. Sidoqoftë, ne pajtohemi të gjithë se energjia elektrike është një mall, një mall shpenzues dhe shërbim, të cilin duhet ta blejmë. Aq sa shpenzojmë edhe ta paguajmë. Duhet ta ngremë një vetëdije te vetë qytetarët dhe të bizneset.

Këtu u fol për kategorinë A+ dhe sigurisht i ofron KEK-u ato mundësitë e veta dhe e ka një rikonfigurim të kriterëve për aplikim për kategorinë A+, pyetja ime është se a bëjnë kërkesa për këtë kategori vetëm bizneset private, apo edhe ato të ashtuquajturat publike, siç janë për shembull spitalet, Trepça në këtë rast, dhe

institucionet tjera, që unë mendoj se është bukur një kompleksitet se si duhet të trajtohen në këtë rast këto çështje. Dhe, ne e dimë se ne jemi për një krijim të klimës së një biznesi të favorshëm, që e përmendi edhe zoti Shahini dhe të tjerë, që shpeshherë na duket se politikat shkojnë në kundërshtim të asaj klime dhe atij angazhimi, që i kemi qitë si prioritet në këtë rast Qeveria.

Unë kam një pyetje, si trajtohet në këtë rast Trepça, kur e dimë se para pak ditësh ata kanë pasur një ndërprerje të energjisë elektrike më shumë se 6 orë dhe mendoj që në kësi raste ne duhet të bëjmë lëshime, sepse specifika e natyrës së punës dallon prej specifikave tjera.

Aty kemi të bëjmë, para së gjithash, me jetën e njeriut. Përderisa ata njerës punojnë 800 metra nën tokë dhe një ndalje e një kohe aq të gjatë e rrymës elektrike kushton edhe me jetë. Do me thënë, ne së pari duhet të kemi parasysh jetën e njeriut e pastaj përfitimet e biznesit e kështu me radhë.

Tjetër, edhe pse s'është temë e këtij diskutimi, ndoshta duhet të mendoj Qeveria për të ardhmen se si të trajtohen në këtë drejtim edhe kompanitë me një status të tillë siç janë ndërmarrjet publike, apo Trepça me një status ende ashtu të padefinuar, as publik e as shoqëror. Bie fjala unë konsideroj, që edhe KEK-u edhe TREPÇA subvencionohen nga Qeveria, nga Buxheti i Kosovës. Dhe në këtë rast këto dy kompani në mes vete ndoshta duhet ta kenë të specifikuar me ligj se si të sillen njëra me tjetrën. Po e përmendi vetëm një rast, edhe pse s'është temë e këtij takimi, furnizimi i TREPÇËS me hirin e KEK-ut.

Ne si Komision Parlamentar e kemi dhënë një rekomandim, që së shpejti do të jetë në seancë të Qeverisë, që të nxjerr një ligj për trajtimin e mbetjeve minerale dhe dihet se si trajtohen ato, në këtë rast si mbetje minerale mund të konsiderohet edhe hiri i KEK-ut dhe përderisa këto dy kompani, të shprehem kështu, figurativisht, pjesë e një familjeje, në këtë rast, pjesë e Qeverisë, a duhet ato të bëjnë biznes në mes vete, ose ta pengojnë procesin e punës të njëra tjetrës ose të ngritet çmimi, në këtë rast i hirit, që i duhet për mbushjen e zgavrave të minierave atje, apo diçka tjetër?

Ndoshta një përgjigje pak më vonë mund ta marr, por kryesisht dëshiroj të di se konsumatorët publik, siç janë: spitalet, Trepça, ... a duhet të bëjnë kërkesë për këtë kategorinë A+, apo duhet t'i trajtojë KEK-u si ndërmarrje me prioritet, pavarësisht e kanë apo nuk e kanë kërkesën ato nënkuptohen si të tilla? Faleminderit!

KRYETARI: E kemi parasysh që e kemi vonu shumë, dy orë e më shumë, edhe ministri ka pasë agjendë edhe ju të tjerët.

Unë ju kisha lutur shkurtë nëse ka edhe pyetje tjera, pastaj mbledhja do të përfundojë. Zoti Kelmendi.

RAMIZ KELMENDI: Ne dimë që çdo ekonomi e biznesit, ekonomisë së mallrave, ekonomisë së vogël familjare i nevojitet energjia. Ne e dimë që ka remonte, për arsye se, prodhuesit janë të detyruar dhe duhet tjetrën anë ...

Ne edhe e dimë që ka ekzistuar kategoria A+, e cila u zbatuar deri sa është fol një kërkesë për ndryshim dhe ndryshimi është bërë për rritjen e inkasimit duke u bazuar në mesataren e shpenzimit dimëror dhe veror. Shqetësimi i këtij biznesi duhet kuptuar shumë seriozisht, me qenë se biznesi krijon marrëdhënie pune dhe punëson njerëz, të cilët në mungesë të energjisë, apo me shtimin e investimit, në mungesë që do të thotë në mungesë të parasë, rrezikohet likuiditeti i këtyre, ata kanë të drejtë të shqetësohen dhe, me ligj është e paraparë që të kihet furnizim kontinual, pa marrë parasysh çfarë niveli dhe madhësie kemi. Dhe KEK-u, në këtë rast që është edhe Qeveria, sepse KEK-u është pjesë përbërëse e Qeverisë, sepse është pjesë kompani publike, ishte dashtë të bëjë planifikimin kualitativ në mënyrë që të kemi furnizim dhe nëse duhet të kemi energji kualitative dhe t'i thithim investitorët e huaj, Qeveria duhet të mendojë, që me rritjen e investimeve dhe investitorëve duhet ta mbajë në barrën e vetë e jo në barrën e prodhuesve vendorë.

Prandaj, unë po mendoj që ishte dashur dhe duhet të trajtohet me kujdes kjo kërkesë, për arsye se kjo ka ekzistuar. Ishte dashtë të trajtohen edhe çështje tjera se çka janë duke bërë edhe shtetet tjera në thithjen e investitorëve të ri në raport me shtetin tonë.

Shteti jonë po vendos një tarifë të re për pagesën e energjisë paraprake të 25%-shit, i cili mund të zgjatë deri në pafundësi dhe mund të zgjatë deri në privatizimin e distribucionit dhe mund të shkojë avancet dhe borxhet të trajtohen të barabarta të një investitor i ri i saj.

KRYETARI: Faleminderit shumë, zoti Kelmenti!
A ka dikush tjetër? Zoti Deshishku.

HASHIM DESHISHKU: Faleminderit, kryetar!
Unë i kam disa pyetje, por më së pari ministrit një pyetje, se tha se nuk do t'i jepim ma para KEK-ut nëse unë s'kam mundësi që me ma la...

Drejtperdrejtë për KEK-un, Zyrën e Rregullatorit: - A është i ligjshëm plani A,B,C për konsumatorin privat. E më së shumti shkon edhe për biznesit, për arsye se planin C e kemi edhe bizneset apo familjet që paguajnë me rregull. Pse ato duhet të pjekin për një... Për disa njerëz që janë të këqij.

ALI HAMITI: Por, shumë njerëz janë të këqij, se 90% s'paguajnë janë të këqij e 10-ëshi, ose pesëshi, qata të shkretë osht mirë mos me i...jo jo ka mënyra, por....

HASHIM DESHISHKU: Tjetra osht... ne e dimë se biznesi duhet të paguaj, apo njeriu që do të ketë rrymë duhet të paguaj, aty pajtona me profesorin, kur tha

duhet, duhet të paguhet muzika, por unë mendoj që KEK-u dhe Oda Ekonomike dhe aleanca duhet të ulen dhe që kur e përfaqësojnë biznesin mendoj se jo 100% të bizneseve edhe Oda ekonomike dhe aleanca por duhet të ulen, ta reduktojnë, apo ta korrigjojnë kontratën e cila do të bie autorizimin e KEK-ut. Por, nëse një biznesmen, një muaj nuk ka mundur ta paguaj një ratë, ai shkyçet për tërë jetën. Unë mendoj se është shumë e gabueshme, sepse unë nisem prej vetit. LESNA mundet me pas një problem qat muaj, tash ndëshkohet për tërë jetën, pse s'ka mundur të informohet. Duhet të ketë KEK-u një tolerancë ndaj bizneseve. Unë duhet të jetë vetëm një muaj.

Dhe, një pyetje e veçantë tjetër. Unë e di se para disa viteve kanë qenë disa programe të KEK-ut për njehsorë që do të jenë me mbushje. A është ai prioritet a po jo, dhe a do të realizohet ajo me mbushjet për familje private që të ketë rrymë gjithmonë. Unë mendoj që duhet të bëhet.

E fundit është që KEK-u si tha zoti Gjokaj, dëgjova që thotë se do të bëjë marrëveshje me bankën qendrore për pagesa, unë mendoj se duhet të bëhet marrëveshja me bankën komerciale. Se banka qendrore nuk e ka atë të drejtë, unë mendoj që në bankën komerciale, tjerat krejt janë në rregull.

KRYETARI: Faleminderit, zoti deputet!
Zoti Hamiti!

ALI HAMITI: Ju po i thoni Qeverisë pse s'po ban politika, pse... kur i ban politikat thoni – pse tash janë politikat, pse A,B,C. Po u them, kjo është një politikë që është bërë në mungesë të energjisë. Ajo energji që është në dispozicion, duhet të ndahet sa më drejtë konsumatorëve që kanë paguar, kjo është absolutisht e ligjshme dhe, nëse ti i ke 800 MW, ata 800 MW , do të thotë t'i shpërndash proporcionalisht me pagesën dhe nivelin e pagesës ose t'i furnizosh edhe më tutje hajnat, që po iu thua ti, në qat sens. Se kryesisht s'mundesh me i inkasue dhe e importon energjinë me 100 MW dhe e falë, sepse e vjedhin. Një pjesë, një mëhallë e cila 95% nuk paguan, do me thënë, pajtohem ... Problemi është ky një në gjendjen çfarë është Kosova, në mungesë sasiore e në mungesë të maksimumit të mbulimit është e detyrueme të bëjë reduktimet pa detyrimisht, sepse nuk është sikur uji, që mundesh në liqe të Batllavës me e ruejt natën e tani ditën e shfrytëzon. Energjia elektrike... ne s'kemi asi kapacitetesh që të mujm... S'ka mundësi, dhe në momentin e shfrytëzimit, kush është profesionist, se unë 100 herë e kam përsëritur, fatkeqësia është se energjinë elektrike nuk mund ta mbanë pezull dhe ta japim në momentin që të vyen aty për aty, sepse në momentin që shfrytëzohet edhe një resho kur ta lëshojsh, dikush qato elektrone duhet në qatë moment me i dhanë. Do të thotë nuk ka ... sistemi duhet të jetë i balancuar. Balancimi i sistemit e detyron shkyçjen ... ose shkyçjen krejt. Tash a është më mirë me bë kolaps, me e shkyç krejt Kosovën, pse s'po e furnizon një mëhallë, apo më e mirë e gjithë të barabartë në mes të regjioneve dhe tue pasur parasysh nevojat e tyre, edhe natyrisht sjelljen e tyre ndaj KEK-ut. Me e shitë atë energji ata që e blejnë, dhe ti e mund ta blesh tjetrën herë. Se qe t'vjen menjëherë

me importu. Ju po thoni, pse s'po importon. Importon 100 euro MW orën në Pik, ndoshta edhe më shumë, e në qat pik ju thoni tan të barabartë me i ba. Në qat pik duhet me e mbajt vetëm sistemin gjallë. E duhet me i reduktue çdo vjet, sepse nuk ke rezervë nëse të mungojnë 100 MW, 100 MW duhet me i shkyç prej Kosovës, sepse nuk i kemi 100MW të kontraktuem sepse kushtojnë. Ajo është poashtu çmim, e aj çmim prap osht në tarifë. E qat tarifë tani idhnohen konsumatorët edhe bizneset se valla na u ka qu përjetë çmimi.

Intenca është që atë energji që e kemi ta ndajmë optimalisht. S'ka tjetër vlerë, tjetër rregull, sepse sistemi duhet të jetë, absolutisht i balancuam dhe ne nuk na durojnë tjerët me u sjellë keq me sistemin sepse jemi prej Moske, në Paris edhe Kosova është e lidhur me gjeneratorët tonë, dhe vrapojnë me të njëjtën qerre sikur të Parisit edhe të Moskës.

HASHIM DESHISHKU: Vetëm një pyetje pata për profesorin. Ju na keni shpjeguar mirë planin A,B,C por, më 15.4., kur e kemi pasur raportin e Zyrës së Rregullatorit të energjisë, ju nuk keni qenë atëherë, njerëzit e juaj kanë thënë nuk është e ligjshme.

ALI HAMITI: Po, kush ka thënë ... gazetatat...

HASHIM DESHISHKU: Jo gazetatat, raportuesit e juaj, njeriu juaj ka thënë!

ALI HAMITI: ... ka gabuar, njeriu....

HASHIM DESHISHKU: ... se është i paligjshëm. A,B,C, është i ligjshëm se po dëmtohet konsumatori.

KRYETARI: Zoti Gjokaj.

ARBEN GJUKAJ: Faleminderit, kryetar!

Unë vetëm shkurtimisht, po kthehem rreth pyetjes së zonjës së nderuar, zonjës Berisha dhe të Trepçës. Edhe një herë dua të cekë. Ne institucionet publike i quajmë institucione të rëndësisë së veçantë. Ujësjiellësat, spitalet, Trepça, në gjuhën Qeveritare, bile edhe institucionet kuvendare, domethënë komunat i trajtojmë në mënyrë krejt në kuptim tjetër domethënë me prioritet dhe kanë prioritet gjatë furnizimit. Nga ata nuk kërkohet që të kenë kategorizim ose të kenë avans. Bile nëpër shumë spitale kanë borxhe po na i furnizojmë. Bile, bile... disa spitale kanë linja të dyfishta. Nëse njëra linjë ka ndonjë problem, automatikisht kyçet linja tjetër. Sepse kështu është furnizimi me FSK-në... ne kemi institucione publike të cilat i furnizojmë me prioritet.

Sa i përket Trepçës. Është e vërtetë, para dy dite ka ndodhë ajo ka ndodhë për shkaqe teknike dhe në montime. Trepça është njoftu për punë. Është bërë një

keqkuptim me njerëzit të cilët, kanë komunikuar dhe ajo është hetuar menjëherë, sepse është udhëzu nëpërmjet Mitrovicës 2.

Sa i përket pyetjes së zotit Deshishku, për hirin, korporata energjetike e Kosovës ka biznes kryesor prodhimin e qymyrit për furnizim të elektranave, dhe nevoja të energjise energjetike dhe distribuim dhe furnizim deri te konsumatori i fundit, por hiri është një proces ose më shumë ka ardhur si kërkesë që shumë industri ose shumë të interesuar kanë kërkuar që të marrin hi. Ne këtë e kemi bërë rregulla të shitjes së hirit, janë nënshkruar kontratat me 5 – 6 kompani, prej tyre është edhe Trepça.

Sa i përket pyetjet së zotit Deshishku për njehsorët elektrik, korporata ka një prioritet tjetër, instalim të njehsorëve digjital në të gjithë territorin e vendit. Momentalisht janë senzibilizu të gjithë konsumatorët biznesor domethënë, mbasi janë shfrytëzues më të mëdhenj, po ashtu kemi ndërtuar instaluar njehsorë në të gjitha pikat e sistemit, nga një pikë niveli ose kufiri me KOST-in deri te, që ne e quajmë stacioni 10.04, kjo na mundëson, monitorimin e rrjedhjes së energjisë dhe inkasimin, gjithashtu edhe markimin e zonave ku janë shpenzimet me të mëdha. Sa i përket njehsorëve me mbushje kjo është një pilot projekt që ka qenë në vitin 2004 – 2005, i cili nuk ka treguar rezultate dhe bile disa gjera janë keqpërdore, se asht ndrrue TVSH-ja dhe tatimet tjera të cilat nuk kanë mundur të inkorporohen në atë sistem. Është i kushtueshëm. Por sistemi i digjitalizimit dhe i vendosjes së smart-bites, që është 24 online në çdo tentim apo çdo prekje e resorit monitorohet nga qendra, ka treguar më shumë efekte dhe është më i favorshëm. Për sa i përket bankave procedurave, jemi keqkuptuar marrëveshja nënshkruhet në mes KEK-ut, Bankës Qendrore dhe konsumatori zgjedh bankën komerciale se ku don me ... Ajo Banka Qendrore është garant i këtij transferi, i jep rregulla dhe i monitoron këto. Unë ua ceka edhe njëherë, ... debiti ka synim kryesor ndarjen e ... fiskal, shpëlarjen e parave dhe për këtë është Banka Qendrore.

KRYETARI: Faleminderit! Zoti ministër!

BESIM BEQAJ: Kryetar të falënderoj, mendoj që ka qenë një debat i nevojshëm dhe një debat shumë i frytshëm, sepse kemi sqaruar të dy palët se nganjëherë ka edhe keqkuptime. Vetë fakti i trajtimit të kategorisë A+, ka ardhur si rezultat i mos kuptimeve të dy anshme, në këtë rast, edhe kuptimet i kanë bërë sipas momentit.

KRYETARI: gjithkush e ka krijuar për veti...

BESIM BEQAJ: Gjithkush e ka lexuar letrën qysh i ka konvnuar për konform asaj, pastaj ka ardhur deri te kjo situatë. Unë mendoj se sa i përket raporteve qofshin ato dy ndërmarrje publike, unë dua ta përsërisë edhe njëherë, Qeveria nuk do të hyjë në marrëdhënie kontraktuale në mes tyre, por ne në politikë nuk ka kompetencë. Ne do të bëjmë politika, të cilat do të ishin të nevojshme për të gjithë kontraktuesit, le të jenë të barabarta për të gjithë.

Sa i përket, a është ligjor ose jo plani A,B, C? Dua të ju them një gjë, se politikat të cilat janë politika në aprovim qeveritar nuk mund të quhen “jo të ligjshme”. Një veprim i tillë, do të thotë, është veprim i cili është marrë në një vendim të Qeverisë dhe i cili me urdhëresë respektive e trajton situatën e krijuar dhe konform situatës së krijuar merr një vendim, i cili realisht i tejkalon vendimet tjera paraprake. Prandaj, duhet të kemi kujdes në këtë drejtim.

Sa i përket që planifikimi kualitativ, që e përmendi Ramizi, dhe ngarkesës së biznesit vendor për investitorët tjerë, mendoj që nuk është situata kështu. Jam plotësisht i bindur, se nuk është ashtu, sepse nuk është 25% nuk është barrë e biznesit për investitorët tjerë, por duhet ta analizojmë në aspektin më afatgjatë. Nëse KEK-u, Rregullatori, Qeveria, prodhuesi të gjithë janë të gatshëm të hyjnë në marrëdhënie kontraktuale për të furnizuar 24 orë rrymë, biznesi do të ketë mundësi që të mos hyjë në planifikim alternative energjetike, të cilat janë shumë më të kushtueshme, në vend se të planifikohet të blihen gjeneratorët, të cilët prishen për ditë, në vend se të blejmë ne për çdo ditë kosto e naftës është shumë e madhe. Atëherë, ... një parapagim i cili bëhet njëherë dhe shkon domethënë, nëpër krejt situatën, vazhdon për 10 vjet, prëderisa janë të respektuara rregullat kundër aktuale. Andaj, duhet të jemi korrektë kur flasim në raport me konsumatorët, në raport me publikën, sepse këtë nuk është masë e Qeverisë, as e KEK-ut për ta ngarkuar biznesin vendor, për ta vu barrën te biznesi vendor në favor të investitorëve të huaj, por është veprim i cili drejtpërdrejt e favorizon zhvillimin ekonomik dhe tregtimin në prioritet konform, një marrëdhënie kontraktuale, e cila bëhet në mes dy subjekteve, e cila duhet të respektohet nga dy anët.

Atëherë, kur nuk ka mundësi biznesi, do ta thotë se kam mundësin me bëe çka me fol tash në parim, a është A,B,C-ja në rregull? Do të thotë, mendojeni këtë çka e tha zoti Hamiti që le të themi që një devijon, një rajon i përgjithshëm, paguan më pak se sa 50% të rrymës tash a duhet të ndalet krejt në atë rajon apo të indentifikohet vendi, se ku është pagesa me problem?

Nuk është zgjedhje ideale, por zgjedhje e imponuar, sepse shteti ka obligim ndaj atyre, të cilët janë të rregulltë në obligimet që i ka ndaj shtetit, t’ia kthejnë atë shërbim. Sigurisht që ky është problem edhe i ligjshmërisë, absolutisht, ju e dini sa ka ngecje në trajtimet e lëndëve nëpër Gjykatë, sepse sikur të ishte shumë më ekspeditive veprimet do të ishin shumë më të shpejta, sepse nëse dikush penalizohet ai penalizohet për një kuart dhe më nuk i bjen asaj.

Sa i përket njësorëve me mbushje, vetëm do të ju jap një komunikim kështu praktik, se njerëzit më kanë treguar. Në njësorë do të eliminohen keqpërdorimi i energjisë, sepse njëtori identifikon pikën defenitive ku energjia hyn në një objekt, por dhe pavarësisht a është njëtori me mbushje apo pa mbushje, del dikush na qet... përpara njëtorit dhe e qon rrymën tjetër kah.

Për këtë arsye, janë njësorët elektronik, të cilët nga qendra dihet a ka dilemë apo nuk ka dilemë, sepse është testuar dhe është treguar që realisht ajo ka ngecje apo jo. Pra, gjithsesi mendoj, se si koncludim është që pagesa, edhe njëher shfrytëzimi i energjisë që është edhe Ligji mbi efqiencën energjetike, të cilin neve para disa

kohe në Kuvend e kemi aprovuar, janë parakushte themelore për furnizim të mirëfilltë energjetikë, sepse le të konsiderojmë që s'ka hiq Kosova prodhime, asnjë burim të vetin, por duhet me importu.

Atëherë, nuk diskutohet fare a ka mundësi me prodhu apo s'ka? E ka tregun, çmimin e tregut konform çmimit tregut duhet të sillemi. Ka plot shtete në botë që s'kanë prodhim energjetik hiq dhe jetojnë, por jetojnë nga shfrytëzimi i mirë edhe nga pagesa, do të thotë, e rregulltë e energjisë elektrike.

Edhe njëherë...

KRYETARI: Faleminderit, shumë!

SALA BERISHA- SHALA: Kryetar, veç një minutë!

KRYETARI: jemi në fund krejt...

SALA BERISHA- SHALA: Veç po dua me sqaru diçka, nuk po du me dal kishe nuk po i kuptoj gjërat, me u sqaru pak edhe me ministrin se që tha: "se Qeveria nuk ka kompetencë me kërkuar mardhënie kontraktuale në mes dy kompanive publike".

Ajo dihet, mirëpo unë po du me sjell një situatë prej përvojës time. Kur kam qenë pjesë e KPMM-së, kur i kemi lëshuar licencat për hulumtime dhe shfrytëzime të minierave më kujtohet që atëherë, se kam ditur se nuk janë të rregulluara me ligj, më patën obliguar, ka qenë kompetencë e ndërkombëtarëve ta përgatis një licencë pikërisht për KEK-un, për shfrytëzimin e qymyrëve.

Dihet se KEK-u minierat janë të përbëra prej disa shtresave gjeologjike qymyrit, sterprenteniteve, rërave dhe zhavorëve dhe ashtu si e përmendi këta laborantin se çfarë shtresa ka, unë e shkruva licencën që duhet, kanë të drejtë ta shfrytëzojnë rërën, zhavorin, sterprentenitin edhe këta krejt edhe këta po thonë "jo". Këta kanë të drejtë ta shfrytëzojnë vetëm qymyrin, e jo ta shesin rërën dhe zhavorin që është shumë i kërkuar në treg e as sterprentenitin, d.m.th. duhet të ketë një rregull, një ligj ose me fjalë tjera, të licencohet për një biznes, të dihet, se cili është për përfitim, të licencohet shkurt thjeshtë.

Ajo dihet, se asete thelbësore të KEK-ut janë qymyri dhe energjia, që e prodhon dhe këto tjerat mund t'i llogaridim si asete jo thelbësore, ose të dorës së dytë, mirëpo pyetja ime ke, se a mund të rregullohet diçka përderisa të dy këto kompani janë të një familje, thjeshtë?

Një familje, janë të Qeverisë së Kosovës dhe unë kisha dashur temë tjetër të jetë kjo...

(Ndërhyrje: ...)

BESIM BEQAJ: A bën... kështu, për të mos e shëndruar debatin në nivel të dy ndërmarrjeve, nëse dikush çfardo institucioni qoftë, është marrë ndonjë masë...

Sa i përket, mbetjeve minerale, mendoj që edhe Trepça edhe KEK-u të dytë kanë shumë punë me bë, për t'i trajtuar mbetjet minerale dhe më duket është një konflencë, e cila do ta'i trajtojë së shpejti, të cilat do të jenë orientimet me mbetjet minerale, se ne kemi mbetje shumë minerale.

Unë besoj që interesi publik është që ne konform kornizave ligjore, t'i trajtojmë këto mbetje në mënyrën më të mirë të mundëshme, por jo të i japim prioritet askujt, pse po them prioritet askujt? Sepse, nesër na vjen, nëse ne i japim sot KEK-ut një rekomandim të tillë, vjen nesër Trepça dhe na thotë: unë kam mbetje

minerale dhe po dua këto mbetje minerale me i shitur, ndoshta me një procedurë që nuk është shumë dhe kërkohet me e shit ose me i dhënë me koncesion apo çfardo qoftë.

Pra, janë disa rregulla. A kanë të drejtë apo s'kanë të drejtë me i shit?

SALA BERISHA- SHALA:Njëra-tjetrës...

BESIM BEQAJ: Jo, jo për aty janë çështje, prapë po them, janë mardhënie kontraktuale në mes të dy subjekteve afariste që unë nuk mundem me hy edhe nuk du me leju vetën me hy, sepse këta mundet të mirren vesh për të dytë kanë mundësi të kompenzimeve njëra me tjetrën, ajo është çështje, do të thotë, tek ndërmarrjet.

Por, sidoqoftë nuk kisha dash që të ndalemi vetëm në trajtimin e dy ndërmarrjeve të tilla...

SALA BERISHA- SHALA:Jo absolut, as unë nuk dashta, por desha veq të jau përkujtoj...

KRYETARI: Faleminderit, shumë!

Të nderuar kolegë,

Ne pas marrjes se procesverbalit ne do t'i nxjerrim disa konkluzione, të cilat mund t'i debatoni në mbledhjen e ardhëshme, si do t'i orientojmë me rekomandime apo me konkluzione.

Dëshiroj, të ju falenderojë shumë, zoti ministër, zoti Hamiti, zoti Gjokaj, përfaqësuesi zoti Rukiqi i Odës Ekonomike...

ALI HAMITI: Faleminderit që na keni thirrur!

KRYETARI:... është kënaqësi, reagimi i deputetëve ka qenë i shpejtë, por nuk ju kemi gjetur juve pa veprim. Është kënaqësi që ju keni ardhur kaq shpejtë secili prej jush, me veprimet të caktuara dhe kjo është me të vërtetë, paraqet një kryesi dhe institucione mjaft të përgjegjshme. Do ta keni mbështetjen e Kuvendit për atë sa të mundemi edhe ne si komision dhe ju ftojmë që në të ardhmen të komunikojmë dhe të bashkëpunojmë me frymën e përgjegjësive që i kemi. Faleminderit, shumë!

Përgatiti:

Njësia e Transkripteve e Kuvendit të Kosovës